



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË**

**Gjykimi i rasteve familjare në Kosovë:
Çështjet lidhur me menaxhimin e lëndëve**

Shkurt 2011

TABELA E PËRMBAJTJEVE

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	- 3 -
HYRJE.....	- 4 -
KORNIZA LIGJORE.....	- 5 -
A) Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut	- 5 -
B) Korniza Ligjore e Kosovës.....	- 11 -
MENAXHIMI I RASTEVE NË PROCEDURAT GJYQËSORE FAMILJARE ..	- 19 -
A) Vonesat	- 19 -
B) Dëshmitarët dhe provat	- 23 -
C) Shqetësimet lidhur me QPS-të	- 25 -
D) Procesverbalet gjyqëore të pasakta dhe jo të kompletuara	- 27 -
E) Arsyetimi i pamjaftueshëm në vendime.....	- 28 -
PËRFUNDIM	- 31 -
REKOMANDIME	- 33 -

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjykatat në Kosovë janë duke dështuar që të gjykojnë në mënyrë të duhur apo adekuate rastet ku përfshihen shpërbërjet e martesave dhe rastet që përshijnë kujdestarinë e fëmijëve dhe vizitat e tyre. Dështimi i tillë shkel kornizën ligjore në Kosovë dhe mund po ashtu të shkel standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në veçanti Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale (KEDNJ) dhe Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF). Mangësi serioze në praktikat e menaxhimit të lëndëve, veçanërisht në lidhje me çështjet e fletëthirrjeve dhe dëshmimeve, rezultojnë në vonesa të mëdha në shqyrtimin e këtyre rasteve. Mangësitë në procedurën e provave nënkuptojnë se rastet gjyqësore familjare shpesh vendosen në mungesë të dëshmisë më të mirë, shpesh në mungesë të provave nga vet palët; në disa raste ato vendosen në mungesë të çfarëdo dëshmie përkatëse.

Qendrat për Punë Sociale (QPS-të) shpesh dështojnë të veprojnë në përputhje me kohën e duhur dhe ndonjëherë dështojnë tërësisht të veprojnë në përputhje me kërkesat nga gjykata për ndihmë lidhur me procedurat e pajtimit ose për mendime lidhur me çështjet për kujdestarinë e fëmijëve. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE) e identifikon edhe këtë si çështje të menaxhimit të lëndëve; ndihma e QPS-së në procedurat e pajtimit dhe raportet lidhur me kujdestarinë e fëmijëve janë të dyja të obligueshme sipas ligjit vendor në Kosovë dhe është detyrë e gjykatave që parashtrajnë kërkesa të tilla t'i përcjellin QPS-të derisa t'u përgjigjen këtyre kërkesave. Veç kësaj, pasaktësitë dhe mangësitë në mbajtjen e procesverbaleve në procedurat gjyqësore familjare nënkuptojnë se palët shumë herë mbesin pa regjistër të besueshëm për atë çfarë ka ndodhur në procedurë, dhe aktvendimet pamjaftueshëm të arsyetuara nënkuptojnë se palët shumë shpesh mbesin pa kuptim të qartë se çfarë ka urdhëruar gjykata në lidhje më ndonjë kërkesë të veçantë ose pse ka vendosur gjykata në mënyrën se si ka vendosur.

Si pjesë e mandatit të vet për të përmirësuar punën e gjyqësisë në Kosovë, dhe qasjen në drejtësi për të gjithë banorët e Kosovës, OSBE në mënyrë periodike raporton mbi fushat tematike brenda sektorit të drejtësisë ku janë identifikuar shqetësime sistemike lidhur me të drejtat e njeriut. Siç demonstroi ky raport, sasia e rasteve përkatëse, mangësitë e identifikuara në gjykime dhe ndikimi në individë – veçanërisht në gra dhe fëmijë – e bëjnë gjykimin e duhur dhe me kohë të rasteve gjyqësore familjare prioritet për Kosovën.

HYRJE

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE) është e brengosur se mangësitë serioze në trajtimin e rasteve familjare në gjykatat në Kosovë mund të shkelin si standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ashtu edhe kornizën ligjore në Kosovë.

Fusha e referuar si ligji për “familjen” është e gjerë, e cila mbulon jo vetëm çështjet aq gjerësisht të gjykuara siç janë shkurorëzimi, alimentacioni, kujdestaria e fëmijëve dhe e drejta për vizitë, por gjithashtu edhe çështjet që ndërlidhen me amësinë dhe atësinë, njohjen dhe strehimin e fëmijëve, adoptimin i fëmijëve, martesë, bashkësinë jashtë-martesorë, anulimin si dhe çështjet që lidhen me marrëdhëniet ndërmjet vëllezërve/motrave, ndërmjet fëmijëve dhe gjyshërve të tyre dhe anëtarëve tjerë të familjes së gjerë. Ky raport nuk ka për qëllim të mbulojë tërë sferën e ligjit për familjen por në vend të kësaj fokusohet në një numër çështjesh procedurale në gjykimin e kontesteve martesore dhe rastet e kujdestarisë së fëmijëve në gjykatat në Kosovë. Këto përfshijnë vonesa të mëdha në zgjidhjen e rasteve, mangësitë në kuptim të dëgjimit të dëshmitarëve dhe administrimit të provave, mangësitë në menaxhimin e rolit të mandatuar të Qendrave për Punë Sociale (QPS-të)¹ në këto raste, praktikat e proces-mbajtjes të pasaktë, dhe aktvendimet pamjaftueshëm të arsyetuara.² Të gjitha këto probleme mund të i atribuohen dështimit për të zbatuar një strategji gjithëpërfshirëse dhe pro-aktive për menaxhimin e lëndëve në këto procedura.

Ky raport së pari shqyrton standardet e aplikueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në veçanti Nenin 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale (KEDNJ) dhe Nenin 3, 9 dhe 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF). Rrjedhimisht, raporti shqyrton dispozitat përkatëse nga ligji vendor, përfshirë Ligjin për Familjen³ dhe ligjin e aplikueshëm mbi Procedurën Kontestimore (LPK).⁴ Së fundmi, ky raport shqyrton rezultatet e monitorimit të procedurave familjare nga OSBE. Identifikon një numër problemesh sistemike që dalin nga praktikat e dobëta për menaxhim të lëndëve dhe vlerëson në kontekst të

¹ Qendrat për Punë Sociale (QPS-të) janë organe qeveritare të cilat operojnë në secilën komunë në Kosovë nën patronatin e Departamentit për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Roli i tyre përshkruhet në Nenin 7 të Ligjit mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare.

² Që prej shkurtit 2008, sistemi i drejtësisë në rajonin e Mitrovicë/Mitrovica ka funksionuar vetëm me kapacitet të kufizuar. Kështu rajoni është lënë pa sistem të drejtësisë tërësisht funksional. Për këtë arsye rajoni i Mitrovicë/Mitrovica paraqet problemet e veta unike vis-à-vis gjykimin të rasteve gjyqësore familjare. Megjithatë këto nuk do të shqyrtohen në këtë raport. Në vend të kësaj, kjo çështje do të diskutohet në një raport të veçantë lidhur me statusin e sistemit gjyqësor. Ngjashëm, çështjet që përfshijnë dispozitat përmbajtësore në vend të atyre procedurale të Ligjit për Familjen nuk do të shqyrtohen në këtë raport por do jenë temë e veçantë shqyrtimi në një raport të ndarë mujor.

³ Ligji për Familjen i Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2006/7, 16 shtator 2006 (Ligji për Familjen).

⁴ Ligji Nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Kosovës Viti III/Nr.38, 20 shtator 2008, (LPK), të cilin gjykatat në Kosovë kanë filluar ta aplikojnë me 6 tetor 2008. Shih po ashtu Ligji bi Procedurën Kontestimore, Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Autonome të Jugosllavisë Nr. 4/1977, 36/1980, dhe 66/1982 të 12 shkurtit 1982, me amendamentet nga viti 1998 (ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 1982). Shumë dispozita në LPK mbesin përmbajtësisht të ngjashme me ato të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të vitit 1982.

rasteve gjyqësore familjare, problemin e vazhdueshëm të aktvendimeve pamjaftueshëm të arsyetuara.

Raporti përfundon se shumica e problemeve të identifikuara në raport mund të përmirësohen me zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie gjithëpërfshirëse dhe proaktive për menaxhim të lëndëve dhe përfundon me një numër rekomandimesh të detajuara për gjykatat, Institutin Gjyqësor të Kosovës dhe QPS-të.

Statistikat që i janë ofruar OSBE-së nga gjykata e qarkut zbulojnë një numër të konsiderueshëm të procedurave gjyqësore familjare që ndodhen pranë gjykatave në Kosovë. Në fillim të vitit 2009, ka pasur një numër të përgjithshëm prej 707 rasteve familjare të viteve të mëhershme të cilat ishin akoma në pritje për t'u zgjidhur. Gjatë vitit 2009, kishin filluar 1,855 raste të tjera gjyqësore familjare. Një numër i përgjithshëm prej 1,444 të rasteve gjyqësore familjare ishin zgjidhur deri nga fundi i vitit 2009, duke lënë një numër të përgjithshëm prej 1,118 të rasteve gjyqësore familjare ende në pritje për t'u zgjidhur derisa viti po përfundonte.⁵ Ende nuk ka në dispozicion statistika të plota për vitin 2010. Megjithatë, është e qartë nga të dhënat statistikore të vitit 2009 se ka pasur një numër shprehimisht më të lartë të lëndëve të reja të parashtruara se sa që ka pasur numër të padive ekzistuese të zgjidhura, një skenar i cili po që se përsëritet në vitin 2010 do të rezultojë në rritje edhe më të madhe të numrit të këtyre lëndëve pranë gjykatave të qarkut në Kosovë.

KORNIZA LIGJORE

A) Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

Neni 6

Neni 6(1) i KEDNJ-së parasheh se, në përcaktimin e “të drejtave dhe obligimeve të tij/saj, çdo kush ka të drejtë për dëgjim korrekt dhe publik brenda kohës së arsyeshme nga gjykata e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj.”⁶

Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ) ka përcaktuar se rastet gjyqësore familjare bien në rubrikën e të “drejtave civile” për qëllime të Neni 6(1).⁷

• *E drejta për qasje në gjykatë*

GjEDNJ ka gjetur se “në çështjet civile vështirë që ndokush mund të perceptojë sundimin e ligjit pa qenë mundësia për të pasur qasje në gjykata.”⁸ “Parimi nëpërmjet të cilit duhet të jetë e mundshme që një padi civile të parashtrohet pranë gjyqtarit radhitet si një parim fundamental ligjor i ‘pranuar’ në mënyrë universale, dhe “e njëjta

⁵ Statistikat ju kanë dhënë monitoruesve të OSBE-së në shtator të vitit 2010 nga personeli i pesë gjykatave të qarkut.

⁶ Neni 6(1) KEDNJ.

⁷ *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNJ, aktgjykimi i 21 shkurtit 1975, paragrafi 33 ;dhe *Airey kundër Irlandës*, GjEDNJ, aktgjykimi i 9 tetorit 1979, paragrafi 26.

⁸ *Ibid.*, paragrafi 34.

vlen për parimin se ligji ndërkombëtar ndalon mohimin e drejtësisë.”⁹ GjEDNJ ka përcaktuar se Neni 6(1) duhet të lexohet në kuptim të këtyre parimeve.

“Do të ishte e papranueshme, në mendim të Gjykatës, po që se Neni 6 paragrafi 1 (neni. 6-1) do të duhej të përshkruaj në detaje garancitë procedurale që i ofrohen palëve në një procedurë ligjore, e të mos mbrojnë së pari atë që në vete faktikisht e bën të mundur përfitimin nga ato garanci, e që ajo është , qasja në gjykatë. Karakteristikat korrekte, publike dhe të shpejta të procedurave gjyqësore nuk kanë kurrfarë vlere nëse nuk ka procedura gjyqësore.”¹⁰

E drejta për qasje përfshinë qasjen faktike si dhe atë në ligj.¹¹ Pengesa në “ushtrimin efektiv së një të drejte është njëlloj si shkëlja e asaj të drejte, edhe po që se pengesa është e karakterit të përkohshëm.”¹² KEDNJ garanton “jo të drejtat që janë teorike apo iluzore por të drejtat që janë praktike dhe efektive [...]. Kjo veçanërisht qëndron kështu për të drejtën e qasjes në gjykata nga kuadri i një vendi të shquar të mbajtur në shoqëri demokratike me të drejtën për gjykim korrekt.”¹³ E drejta për qasje mund të shkelet jo vetëm kur parashtruesi i kërkesës nuk ka mundësi të fillojë procedurën por edhe kur procedura, pasi të ketë filluar, vonohet nga gjykata për periudha të gjata.¹⁴ E drejta për qasje parasheh obligim pozitiv për të pasur të vendosur një “sistem të kuptueshëm” që rregullon qasjen në gjykata.¹⁵ Sistemi duhet të t’i ofrojë palëve gjyqësore “mundësi të qartë, praktike dhe efektive” për të filluar procedurën. E drejta për qasje po ashtu përfshin obligimin pozitiv për t’i shërbyer palëve dokumentet dhe t’i mbajë të informuara palët lidhur me datat e seancave dhe vendimet e nxjerra gjatë procedurës.¹⁶

- **Dëgjimi korrekt dhe publik**

E drejta për dëgjim korrekt përfshin të drejtën për vendim të arsyetuar. GjEDNJ ka përcaktuar se derisa autoritetet gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të duhura për të siguruar që sistemet e tyre të drejtësisë veprojnë në pajtim me kushtet nga Neni 6(1), gjykatat e tyre duhet të “tregojnë me qartësi të mjaftueshme bazat mbi të cilat kanë mbështetur vendimin e tyre.”¹⁷ Në një aktgjykim të kohëve të fundit

⁹ Ibid., paragrafi 35.

¹⁰ Ibid.

¹¹ Ibid., paragrafi 26. Shih po ashtu *Silver dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNJ, aktgjykim i 25 shkurtit 1983, paragrafët 80-82.

¹² Ibid. Shih po ashtu *Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNJ, aktgjykim i 28 qershorit 1984, paragrafi 107.

¹³ *Airey kundër Irlandës*, GjEDNJ, aktgjykim i 9 nëntorit 1979, paragrafi 24.

¹⁴ *Kutić kundër Kroacisë*, GjEDNJ, aktgjykim i 1 marsit 2002, paragrafët 24-33; *Multiplex kundër Kroacisë*, GjEDNJ, aktgjykim i 10 korrikut 2003, paragrafët 41-55; dhe *Aćimović kundër Kroacisë*, GjEDNJ, aktgjykim i 9 tetorit 2003, paragrafët 28-42. Shih po ashtu *Ganci kundër Italisë*, GjEDNJ, aktgjykim i 20 tetorit 2003, paragrafët 27-31; *Marini kundër Shqipërisë*, GjEDNJ, aktgjykim i 18 dhjetorit 2007, paragrafët 141-146; dhe *Dubinskaya kundër Rusisë*, GjEDNJ, aktgjykim i 13 korrikut 2006, paragrafët 39-46.

¹⁵ *De Geoffre de la Pradelle kundër Francës*, GjEDNJ, aktgjykim i 16 dhjetorit 1992, paragrafët 34 dhe 35.

¹⁶ *Sukhorubchenko kundër Rusisë*, GjEDNJ, aktgjykim i 10 shkurtit 2005, paragrafët 53 dhe 54; dhe *Dubinskaya kundër Rusisë*, GjEDNJ, aktgjykim i 13 korrikut 2006, paragrafët 42-46.

¹⁷ *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, GjEDNJ, aktgjykim i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33.

GjEDNJ ka ripërsëritur se “aktgjykimet e gjykatave dhe tribunaleve do të duhej që në mënyrë adekuate të deklarojnë arsyet mbi të cilat mbështeten.”¹⁸

“Neni 6[1] obligon gjykatat që të japin arsye për vendimet e tyre, por nuk mund të kuptohet si kërkesë për përgjigje të detajuar për secilin argument. Se në çfarë mase ky detyrim për të dhënë arsye kërkohet mund të ndryshojë bazuar në natyrën e vendimit [...]. Edhe pse gjykata vendore ka një margjinë të vlerësimit kur zgjedh argumentet në një rast të veçantë dhe pranon dëshmi në mbështetje të parashtrësive të palëve, një autoritet është i obliguar të justifikojë veprimet e veta duke dhënë arsye për vendimet e veta [...]. Një tjetër funksion i një vendimi të arsyetuar është që të ja demonstrojë palëve se ata janë dëgjuar. Veç kësaj, një vendim i arsyetuar i ofron palës mundësinë që të paraqet ankesë kundër tij, si dhe mundësinë që organi për ankesa ta rishqyrtojë atë. Vetëm përmes nxjerrjes së një vendimi të arsyetuar mund të ketë besim të publikut në administrim të drejtësisë [...].”¹⁹

- **Brenda kohës së arsyeshme**

Neni 6(1) parasheh që rastet të zgjidhen brenda kohës së arsyeshme. GjEDNJ ka përcaktuar se ky kusht “nënvizon rëndësinë e ndarjes së drejtësisë pa vonesa, të cilat mund ta rrezikojnë besueshmërinë dhe efikasitetin e saj.”²⁰ Të gjitha procedurat e mbuluara nga Neni 6(1) i nënshtrohen kushtit për kohë të arsyeshme.²¹ GjEDNJ ka përcaktuar se “[a]rshyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në kuptim të rrethanave të veçanta të rastit [...], duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e rastit” si dhe sjelljen e parashtrësit të kërkesës dhe autoriteteve kompetente.²²

Në vlerësimin e ndërlikueshmërisë së rastit, GjEDNJ do të shqyrtojë vëllimin dhe ndërlikueshmërinë e provave,²³ numrin e palëve të përfshira,²⁴ nevojën për të marr mendim të ekspertit²⁵ apo dëshmi nga jashtë vendit,²⁶ dhe ndërlikueshmërinë e çështjeve ligjore në rast.²⁷ Sa i përket sjelljes së parashtrësit të kërkesës, nga ai apo ajo “kërkohet që të tregojnë përkushtim gjatë marrjes së hapave procedural që kanë të bëjnë me [atë apo ato], të përmbahen nga përdorimi i taktikave që shkaktojnë vonesa dhe të veprojnë në dobi të [tij apo saj] në fushën e ofruar nga ligji vendor për shkurtim të procedurës.” Parashtrësi i kërkesës “nuk ka për detyrë të ndërmerri ndonjë veprim i cili nuk është i dobishëm për atë qëllim”.²⁸ Gjykata nuk është përgjegjëse për vonesën e shkaktuar nga sjellja e parashtrësit të kërkesës. Pala gjyqësore ka të drejtën për të shfrytëzuar plotësisht të drejtat e veta procedurale; megjithatë kur duke e bërë këtë vonon procedurën, gjykata nuk do të mbahet përgjegjëse për atë pjesë të vonesës.²⁹

¹⁸ *Tatishvili kundër Rusisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58.

¹⁹ *Ibid.*

²⁰ *H kundër Francës*, GjEDNJ, aktgjykimi i 24 tetorit 1989, paragrafi 58.

²¹ *König kundër Gjermanisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 28 qershorit 1978, paragrafi 96.

²² *H kundër Francës*, GjEDNJ, aktgjykimi i 24 tetorit 1989, paragrafi 50. Shih po ashtu *König kundër Gjermanisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 28 qershorit 1978, paragrafi 99; dhe *Pedersen dhe Baadsgaard kundër Danimarkës*, GjEDNJ, aktgjykimi i 17 dhjetorit 2004, paragrafët 45-51.

²³ *Eckle kundër Gjermanisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 15 korrikut 1982, paragrafët 80-81.

²⁴ *Neumeister kundër Austrisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 27 qershorit 1968, paragrafi 21.

²⁵ *Wemhoff kundër Gjermanisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 27 qershorit 1968, paragrafi 8.

²⁶ *Neumeister kundër Austrisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 27 qershorit 1968, paragrafi 21.

²⁷ *Ibid.*

²⁸ *Unión Alimentaria Sanders SA kundër Spanjës*, GjEDNJ, aktgjykimi i 7 korrikut 1989, paragrafi 35.

²⁹ *König kundër Gjermanisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 28 qershorit 1978, paragrafi 105.

Megjithatë, madje edhe kur një masë e përgjegjësive për vonesën qëndron tek palët, ky faktor nuk mund të përjashtojë përgjegjësinë autoriteteve të sistemit gjyqësor.³⁰

Autoritetet do të mbahen përgjegjëse kur kuptohet se vonesa i atribuohet sistemeve të veta gjyqësore apo administrative. Autoritetet janë mbajtur përgjegjëse për vonesat në gjykatat civile dhe administrative gjatë kryerjes së “veprimeve procedurale të karakterit rutinor”,³¹ gjatë caktimit të seancave nga gjykatat,³² gjatë paraqitjes së provave nga organi administrativ,³³ dhe për “vështirësitë e krijuara nga mungesa e koordinimit ndërmjet autoriteteve të ndryshme të përfshira”.³⁴ Madje edhe kur kohëzgjatja e secilës fazë të procedurës, nëse shikohet në mënyrë individuale, mund të mos duket e paarsyeshme, kohëzgjatja e përgjithshme e procedurës mund akoma të konsiderohet si e tej-zgjatur dhe si e tillë mund të thuhet se nuk ka plotësuar kushtin e kohës së arsyeshme.³⁵

Në vlerësimin se a ka qenë e arsyeshme një vonesë e veçantë, GjEDNJ po ashtu merr parasysh atë se çfarë ka përpara në rastin gjyqësor.³⁶ Përsheptim i veçantë kërkohet në rastet që kanë të bëjnë, *inter alia*, me punësimin,³⁷ statusin shoqëror,³⁸ kujdestarinë e fëmijëve dhe qasjen,³⁹ mirëmbajtjen,⁴⁰ shëndetin,⁴¹ sigurimin social,⁴² reputacionin⁴³ dhe titullin në pronë.⁴⁴

³⁰ *Bock kundër Gjermanisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 29 marsit 1989, paragrafi 41.

³¹ *Guincho kundër Portugalisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 10 korrikut 1984, paragrafi 36.

³² *König kundër Gjermanisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 28 qershorit 1978, paragrafët 110-111.

³³ *H kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykimi i 8 korrikut 1987, paragrafi 81. Organi administrativ në këtë çështje ishte një Këshill Shtetëror funksioni i të cilit ishte t'i ofrojë parashtruesit të kërkesës përkrahje sociale të punës.

³⁴ *Wiesinger kundër Austrisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 30 tetorit 1991, paragrafi 64.

³⁵ *Uhl kundër Gjermanisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 10 shkurtit 2005, paragrafi 33.

³⁶ *Frydlander kundër Francës*, GjEDNJ, aktgjykimi i 27 qershorit 2000, paragrafi 43 thotë “‘arsyeshmëria’ e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në kuptim të rrethanave të rastit dhe me referim të kritereve në vijim: ndërlikueshmërisë së rastit, sjelljes së parashtruesit të kërkesës dhe të autoriteteve relevante dhe çështjeve që shqyrtoheshin në kontest lidhur me parashtruesin e kërkesës.”

³⁷ *Buchholz kundër Gjermanisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 6 majit 1981, paragrafi 52 thotë “atë që ka pasur në shqyrtim gjyqësor ka qenë e rëndësishme së madhe për Z. Buchholz: ajo që ishte e përfshirë ishte ose rivendosja në vend të punë ose shpërbllim me kompensim në rast të përfudimit të kontratës.”

³⁸ *Sylvester kundër Austrisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 3 shkurtit 2005, paragrafi 32 thotë: “Gjykata ka ripërsëritur se, në rastet që kanë të bëjnë me statusin shoqëror, kërkohet përkushtim i veçantë në kuptim të pasojave të mundshme që mund të shkaktojë kohëzgjatja e madhe e procedurës, shprehimisht në gëzimin e të drejtës për respektimin e jetës familjare [...]”

³⁹ *Hokkanen kundër Finlandës*, GjEDNJ, aktgjykimi i 23 shtatorit 1994, paragrafi 72, thotë se “është esenciale që rastet e kujdestarisë të kryhen shpejtë” megjithatë po ashtu nënvizoi që GjEDNJ “nuk sheh arsye të kritikojë Gjykatën e Qarkut që ka suspenduar dy herë procedurën në mënyrë që të merr mendimet e ekspertëve lidhur me çështjet që ishin parashtruar pranë saj.” Shih po ashtu *H kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNJ, aktgjykimi i 8 korrikut 1987, paragrafët 87-90. Në këtë rast çështja e ankesës së parashtruesit ndërliqej me adoptim the qasje; paragrafi 85 thotë “[...]Gjykata e konsideron si të drejtë vendosjen e theksit të veçantë mbi rëndësinë e asaj që ishte në shqyrtim për parashtruesin e kërkesës gjatë procedurës në fjalë. Jo vetëm që ato ishin vendimmarrëse për marrëdhëniet e saj të mëvonshme me fëmijën e saj, por ato kishin kualitet të veçantë ireversibil [...]. Në raste të këtij lloji, autoritetet kanë për detyrë të ushtrjnë zell të posaçëm pasi që [...]çdo herë ekziston rreziku që çfarëdo vonese procedurale do të rezultojë në vendosjen *de facto* të çështjes së parashtruar pranë gjykatës, para se ajo të mbajë seancën e parë dëgjimore.”

⁴⁰ *Kubiznakova kundër Republikës Çeke*, GjEDNJ, aktgjykimi i 21 qershorit 2005, paragrafi 27.

⁴¹ *Bock kundër Gjermanisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 29 marsit 1989, paragrafi 49.

Autoritetet kanë obligim pozitiv “për të organizuar sistemet e tyre të drejtësisë në atë mënyrë që gjykatat e tyre mund të plotësojnë të gjitha kushtet e tyre, përfshirë edhe obligimin për t’i dëgjuar rastet brenda kohës së arsyeshme”.⁴⁵ Ky detyrim ekziston pa marr parasysh shpenzimet.⁴⁶

Autoritetet nuk do të mbahen përgjegjëse për “një mbingarkesë të përkohshme në punën e gjykatave” nëse ato “ndërmarrin veprime të duhura për ta përmirësuar atë me shpejtësinë e nevojshme.” Megjithatë një “mbingarkesë kronike” nuk mund të shfrytëzohet për të “arsyetuar kohëzgjatjen e tepruar të procedurës.”⁴⁷ Autoritetet mund të mbahen përgjegjëse aty ku kanë zgjedhur të trajtojnë mbingarkesën me lëndë duke i dhënë prioritet atyre më urgjente dhe të rëndësishme mes tyre, nëse rezultati i atij sistemi është që rastet jo-urgjente të mbesin jo-aktive për periudha të gjata kohore.⁴⁸ Një sistem i vendosjes në prioritet të rasteve, bazuar në urgjencë apo rëndësi mund të shërbej si një mjet i përkohshëm, për një afat të shkurtë kohor.⁴⁹ Megjithatë, kur një sistem i tillë “bëhet çështje e organizimit strukturor”, mbingarkesa nuk mund të konsiderohet më e përkohshme dhe autoritetet përgjegjëse do të mbahen përgjegjëse nëse nuk adoptojnë masa më efektive për të përmirësuar situatën.⁵⁰

Neni 8

Përveç Nenit 6, Neni 8 mund të jetë relevant kur merret parasysh se a ka pasur pajtueshmëri me KEDNJ-në, gjatë gjykimit të një padie familjar. Neni 8 i garanton çdokujt “të drejtën për respektimin e jetës së tij private dhe familjare, shtëpisë dhe korrespondencës së tij”⁵¹ dhe parasheh se

“[n]uk do të ketë ndërhyrje nga autoriteti publik në gëzimin e kësaj të drejte përveç nëse është në pajtim me ligjin dhe është e domosdoshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike ose mirëqenies

⁴² *Deumeland kundër Gjermanisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 29 majit 1986, paragrafi 90.

⁴³ *Pieniżek kundër Polonisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 28 shtatorit 2004, paragrafi 28 thotë se “veprimi i parashtruesit të kërkesës kishte të bënte me mbrojtjen e të drejtave të saj personale, d.m.th. namin dhe reputacionin e saj të mirë. Andaj, [...] ajo se çfarë ishte në shqyrtim gjyqsor ishte padyshim e rëndësishë së madhe për parashtruesen e kërkesës dhe kërkonte që gjykatat vendore të shprehin zell dhe të veprojnë me shpejtësi gjatë trajtimit të rastit të saj.”

⁴⁴ *Poiss kundër Austrisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 29 shtatorit 1987, paragrafët 58 dhe 60; dhe *Hentrich kundër Francës*, GjEDNJ, aktgjykimi i 22 shtatorit 1994, paragrafi 61.

⁴⁵ *Süssmann kundër Gjermanisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, paragrafi 55. Për më tepër, autoritetet mund të mbahen përgjegjëse jo vetëm për çfarëdo vonese në trajtimin e një rasti të veçantë në operimin e një sistemi përgjithësisht të shpejtë për administrimin e drejtësisë, por po ashtu edhe për dështimin për të rritur resurset në përgjigje ndaj mbingarkesës me lëndë dhe për mangësi strukturore në sistemin e vet të drejtësisë që shkaktojnë vonesa. Shih Harris, O’Boyle & Warbrick. *Law of the European Convention on Human Rights Orig., edicioni i dytë*, Oxford University Press, 2009, faqet 278-284.

⁴⁶ *Airey kundër Irlandës*, GjEDNJ, aktgjykimi i 9 tetorit 1979, paragrafi 20.

⁴⁷ *Klein kundër Gjermanisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 27 tetorit 2000, paragrafi 43. Shih po ashtu Harris, O’Boyle & Warbrick. *Law of the European Convention on Human Rights Orig., edicioni i dytë*, Oxford University Press, 2009, fq. 282.

⁴⁸ *Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës*, GjEDNJ, aktgjykimi i 13 korrikut 1983, paragrafi 29. Rasti i parashtruesit të kërkesës kishte qëndruar pezull për një periudhë gati tre vite e gjysmë.

⁴⁹ *Süssman kundër Gjermanisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, paragrafi 60.

⁵⁰ *Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës*, GjEDNJ, aktgjykimi i 13 korrikut 1983, paragrafi 29. Shih po ashtu *Guincho kundër Portugalisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 10 korrikut 1984, paragrafi 40.

⁵¹ Neni 8(1), KEDNJ.

ekonomike të vendit, për parandalim të trazirave apo krimet, për mbrojtjen e shëndetit apo moraleve, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të së tjerëve.”⁵²

GjEDNJ në shumë raste ka ripërsëritur se “objekti thelbësor i Neni 8 është që të mbrojtë individin nga veprimi arbitrar nga autoritetet publike” dhe se, veç kësaj ka “obligime pozitive të pandara në ‘respektimin’ efektiv për jetë familjare.”⁵³

GjEDNJ ka zbatuar garancitë nga Neni 8 në një gamë të gjerë çështjesh. Nën rubrikën e mbrojtjes së “jetës familjare”, është gjetur se Neni 8 aplikohet, *inter alia*, në rastet që përfshijnë martesën dhe prishjen e martesës, atësinë, abortin, inseminimin artificial dhe format tjera të teknologjisë reproduktive, njohjes dhe strehimit të fëmijëve, adoptimin e fëmijëve, marrëdhëniet ndërmjet vëllezërve/motrave dhe ndërmjet gjyshërve dhe nipave/mbesave dhe kujdestarinë e vizitat e fëmijëve.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve(KDF)

KDF përmban një numër dispozitash përkatëse në lidhje me gjykimin e rasteve gjyqësore familjare. Neni 3(1) parasheh se

“[n]ë të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të marra nga institucionet private apo publike të mirëqenies shoqërore, gjykatave, autoriteteve administrative apo organeve legislative, interesat më të mirë të fëmijës do të jenë konsiderate primare.”⁵⁴

Neni 9 kërkon nga autoritet të sigurojnë se

“[...]fëmija nuk do të ndahet nga prindërit e tij apo asaj kundër vullnetit të vet, përveç në raste kur autoritetet kompetente, subjekt për rishikim gjyqësor përcaktojnë, në përputhje me ligjin dhe procedurat e aplikueshme, se ndarja e tillë është e domosdoshme për interesat më të mirë të fëmijës. Përcaktimi i tillë mund të jetë i domosdoshëm në një rast të veçantë siç mund të jetë rasti ku përfshihet abuzimi apo neglizhimi i fëmijës nga prindërit, apo rasti kur prindërit jetojnë ndaras dhe duhet të merret vendimi lidhur me vendin e banimit të fëmijës.”⁵⁵

Neni 9 parasheh se në procedura të tilla, “të gjitha palëve të interesuara duhet t’u jepet mundësia të marrin pjesë në procedurë dhe t’i bëjnë të ditura vështrimet e tyre.”⁵⁶ Autoritetet duhen të “respektojnë të drejtën e fëmijës i cili është ndarë nga njëri apo dy prindërit për të mbajtur marrëdhënie personale dhe kontakt të drejtpërdrejtë me të dy prindërit rregullisht, përveç nëse kjo është në kundërshtim me interesat më të mirë

⁵² Neni 8(2), KEDNJ.

⁵³ Shih, *inter alia*, *Bajrami kundër Shqipërisë*, KEDNJ, aktgjykimi i 12 dhjetorit 2007, paragrafët 53-55 dhe 66-68. GjEDNJ ka përcaktuar se: “Pa marrë parasysh mos-ratifikimin nga ana e Shqipërisë të instrumenteve përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë, Gjykata gjen se sistemi i drejtësisë i Shqipërisë, siç qëndron, nuk ka ofruar ndonjë kornizë alternative që do t’i mundësonte parashtruesit të kërkesës mbrojtjen efektive dhe praktike që kërkohet nga obligimi pozitiv i Shtetit të paraparë me Nenin 8 të Konventës” (paragrafi 67 i aktgjykimit). Aktgjykimi i referohej Konventës së Hagës mbi Rrëmbimin e Fëmijëve të 25 tetorit 1980.

⁵⁴ Neni 3(1), KDF.

⁵⁵ Neni 9(1), KDF.

⁵⁶ Neni 9(2), KDF.

të fëmijës.”⁵⁷ Neni 12 trajton të drejtën e fëmijës për tu dëgjuar. Kërkon që autoritetet të i “sigurojnë fëmijës së aftë për të formuar vështrimet e veta personale, të drejtën që ti shpreh ato vështrime lirshëm në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me fëmijën, duke i dhënë vështrimeve të fëmijës peshën e duhur në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës”⁵⁸ Parasheh se “fëmijës në veçanti do t’i ofrohet mundësia që të dëgjohej në çfarëdo procedure gjyqësore apo administrative që ka të bëjë me fëmijën, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet përfaqësuesit apo ndonjë organi të përshtatshëm, në mënyrë që është në përputhje me rregullat procedurale të ligjit kombëtar.”⁵⁹

B) Ligji vendor

Dispozitat e përgjithshme

Ligji për Familjen “rregullon fejesën, martesën, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, adoptimin (birësim), kujdestarinë, mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, marrëdhëniet pasurore në familje dhe procedurat e posaçme të gjykatës përkitazi me kontestet lidhur me marrëdhëniet familjare.”⁶⁰ “Familja” definohet si “bashkësi vitale e prindërve dhe fëmijëve të tyre si dhe personave tjerë në gjini”⁶¹ dhe “bërthamë natyrore dhe themelore e shoqërisë”.⁶² Rregullimi i marrëdhënieve familjare bazohet në parimet për “barazinë ndërmjet burrit dhe gruas, respektit dhe ndihmës së ndërsjellët ndërmjet tyre [dhe] anëtarëve të familjes”,⁶³ “mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe përgjegjësia e të dy prindërve për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre”⁶⁴ dhe obligimin e prindërve dhe fëmijëve t’i ofrojnë “ndihmë dhe konsideratë të ndërsjellët gjatë tërë jetës së tyre”.⁶⁵ Fëmijët nga prindërit e pamartuar “gëzojnë të drejtat e njëjta dhe kanë detyrime të njëjta sikurse fëmijët e lindur nga prindërit të cilët kanë qenë të martuar në kohën e lindjes së [tyre].”⁶⁶

Martesa

Martesa definohet si “bashkësi e regjistruar ligjërish në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes”.⁶⁷ Bashkëshortët janë të barabartë “në të gjitha marrëdhëniet personale dhe pronësore” që karakterizojnë martesën.⁶⁸ Martesa “lidhet për tërë kohëzgjatjen e jetës.”⁶⁹ Bashkëshortët “janë të detyruar të jenë besnik ndaj njëri tjetrit dhe në mënyrë reciproke ta ndihmojnë, respektojnë dhe mbështesin

⁵⁷ Neni 9(3), KDF.

⁵⁸ Neni 12(1), KDF.

⁵⁹ Neni 12(2), KDF.

⁶⁰ Neni 1, Ligji për Familjen.

⁶¹ Neni 2(1), Ligji për Familjen.

⁶² Neni 2(2), Ligji për Familjen.

⁶³ Neni 3(1), Ligji për Familjen.

⁶⁴ Neni 3(2), Ligji për Familjen.

⁶⁵ Neni 3(3), Ligji për Familjen.

⁶⁶ Neni 3(4), Ligji për Familjen.

⁶⁷ Neni 14(1), Ligji për Familjen. Neni 14(2) parasheh se “[m]ashkulli dhe femra kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të formojnë familje pa ndonjë kufizim në bazë të racës, kombësisë apo religjionit, si dhe janë të barabartë gjatë lidhjes së martesës, vazhdimit të martesës dhe zgjidhjes së saj.”

⁶⁸ Neni 42(1), Ligji për Familjen.

⁶⁹ Neni 42(2), Ligji për Familjen.

financiarisht njeri tjetrin, posaçërisht në rastet kur njëri prej tyre nuk ka bazë të mjaftueshme materiale për jetesë.”⁷⁰

Shuarja e martesës

Gjykatat që trajtojnë situatat ku ka pasur shuarje të martesës duhet të marrin parasysh parimin e përgjithshëm që “institucioni i martesës duhet të ruhet.”⁷¹ Për këtë qëllim, “bashkëshortët në martesë e cila mund të jetë shkëputur duhet të inkurajohen ti marrin të gjitha hapat e zbatueshëm përmes këshillimit për martesë, procedurave të pajtimit [...] ose tjera për ta ruajtur martesën.”⁷² Megjithatë, “martesa e cila në mënyrë të pakthyeshme është shkëputur duhet të shuhet” dhe kjo do të duhej të bëhet “me një minimum të shqetësimit për palët dhe fëmijët e prekur”, “në atë mënyrë që të promovojnë sa më mirë marrëdhënie të vazhdueshme mes palëve dhe fëmijëve të prekur si është e mundur në rrethanat” dhe “pa shpenzime të paarsyeshme të përfshira në lidhje me procedurat që duhet ndjekur në sjelljen e martesës në një përfundim”.⁷³ Veç kësaj, “çdo rrezik për të keqe ose dhunë ndaj bashkëshortëve dhe fëmijëve duhet të shmanget.”⁷⁴

Shkurorëzimi

Martesa “mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm në bazë të vendimit të gjykatës.”⁷⁵ Ose “njëri apo të dy bashkëshortët me marrëveshje të dyanshme mund të kërkojnë shkurorëzim” duke parashtruar padi “në gjykatën kompetente”.⁷⁶ Shkurorëzimi mund të kërkohet “kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht ose në mënyrë të vazhdueshme, ose kur për shkaqe të tjera është zgjidhur në mënyrë të pa kthyeshme.”⁷⁷ Bashkëshorti apo bashkëshortët nuk mund të parashtrorjnë padi për shkurorëzim “gjatë shtatzënisë së gruas dhe derisa fëmija i tyre i përbashkët t’i këtë mbushur një vit.”⁷⁸ Kur ka fëmijë nga martesa, propozimi për shkurorëzim me marrëveshje të dyanshme duhet të përmbajë “marrëveshjen me shkrim për përkujdesje, edukim dhe ushqim të fëmijëve të tyre të përbashkët si dhe propozimin me shkrim mbi atë se si kontaktet personale mes fëmiut dhe të dy prindërve do të garantohen në të ardhmen.”⁷⁹

Përpjekjet për pajtim

Gjykata nuk do ta lejojë shkurorëzimin derisa të mos bëhen përpjekje për pajtim “të zhvilluara nga gjykata në seanca të veçanta”.⁸⁰ Ky kusht megjithatë nuk do të zbatohet

⁷⁰ Neni 42(3), Ligji për Familjen.

⁷¹ Neni 59(1), Ligji për Familjen.

⁷² Neni 59(2), Ligji për Familjen.

⁷³ Neni 59(3), Ligji për Familjen.

⁷⁴ Neni 59(4), Ligji për Familjen.

⁷⁵ Neni 68(1), Ligji për Familjen.

⁷⁶ Neni 68(2), Ligji për Familjen. Por shih Nenin 68(4), i cili parasheh se edhe po që se nuk është arritur me marrëveshje të ndërsjellë, padia për shkurorëzim do të konsiderohet e parashtruar si e tillë nëse bashkëshorti i paditur “deklaron shprehimisht se nuk e kundërshton bazueshmërinë e kërkesëpadisë” të bërë në parashtresë.

⁷⁷ Neni 69(1), Ligji për Familjen. “Shkaqet tjera” përfshijnë “jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, veprat penale kundër jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, lënia qëllimkeqe dhe e paarsyeshme, sëmundja psikike e pashërueshme dhe paaftësia e vazhduar për të vepruar, ndërprerja e paarsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dyanshme”: Neni 69(2), Ligji për Familjen.

⁷⁸ Neni 70(1), Ligji për Familjen.

⁷⁹ Neni 70(2), Ligji për Familjen.

⁸⁰ Neni 76(1), Ligji për Familjen.

kur njërit nga bashkëshortëve u mungon aftësia për të vepruar,⁸¹ kur njëri apo dy bashkëshortët jetojnë jashtë vendit,⁸² ose kur vendbanimi i njërit prej bashkëshorteve është i panjohur.⁸³ Gjykata nuk do ta përfundojë shkurorëzimin deri pas mbajtjes së seancave të veçanta dhe kur gjykata ka ardhur në përfundim se “pajtimi nuk ka pasur sukses.”⁸⁴

Kur bashkëshortët kanë fëmijë të mitur, Ligji për Familjen parasheh që procedura e pajtimit të kryhet nga QPS, e cila do të aplikojë “metodat e punës sociale [...] metoda tjera profesionale” dhe do të shfrytëzoj shërbimet e këshillimit për martesë dhe familje si dhe shërbimet tjera profesionale.⁸⁵ QPS do të vlerësojë së në “çfarë kushte për jetë dhe zhvillim” ndodhen fëmijët e mitur, dhe do të “mbrojë interesat e fëmijëve” duke ndërmarr “të gjitha masat e nevojshme” për të siguruar që edukimi, siguria dhe mbajtja financiare janë marr parasysh në mënyrë të duhur në çfarëdo marrëveshje ndërmjet bashkëshortëve.⁸⁶ Procedurat e pajtimit të kryera nga QPS-të nuk do të zgjasin më shumë se tre muaj, përpos nëse kështu pajtohen bashkëshortët. QPS “pa vonesë” do të parashtrorë pranë gjykatës raport me shkrim “lidhur me rezultatin e procedurës së pajtimit.”⁸⁷

Çështjet procedurale

LPK parasheh rregullat procedurale që duhet të ndiqen në rastet që kanë të bëjnë me “kontestet nga marrëdhëniet juridiko-civile të personave fizikë dhe juridikë, po që se me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe.”⁸⁸

• *Para seancës përgatitore*

Gjykata, posa ta pranojë padinë do të iniciojë përgatitjet për shqyrtimin kryesor. Përgatitjet e tilla do të përfshijnë ekzaminimin e padisë, ndërmarrjen e hapave për të ja shërbyer padinë të paditurit dhe marrjen e përgjigjes të tij/saj në padi, mbajtjen e seancës përgatitore dhe caktimin e datës për seancën e shqyrtimit kryesor.⁸⁹ Nëse, pas ekzaminimit të padisë, gjykata vjen në përfundim se ajo është e “paqartë”,⁹⁰ “e pakuptueshme apo “jo e plotë” gjykata mund “ ta thërrasë personin që e dërgon ta korigjojë ose ta plotësojë [padinë].”⁹¹ Nëse gjykata gjen se padia nuk bie nën juridiksionin e gjykatës, tashmë veçse është trajtuar në formë të “kontratë për zgjidhjen e kontestit të tyre nga arbitrazh”, veçse ndodhet pranë gjykatës (*lis pendens*), tashmë veçse është gjykuar (*res judicata*), ose është parashtruar pas skadimit të afatit, gjykata mund ta hedh padinë poshtë si të palejueshme.⁹² Gjykata do të ja dërgojë të paditurit padinë, “me shkresat e bashkangjitura”, brenda 15 ditëve nga dita kur është paraqitur në gjykatë.⁹³ I padituri ka edhe 15 ditë tjera nga data e pranimit të padisë që të

⁸¹ Neni 76(1).1, Ligji për Familjen.

⁸² Neni 76(1).2, Ligji për Familjen.

⁸³ Neni 76(1).3, Ligji për Familjen.

⁸⁴ Neni 77(2), Ligji për Familjen.

⁸⁵ Neni 80(1), Ligji për Familjen. Procedurat e shfrytëzuara do “të mbështeten nga parimet e vullnetit të mirë dhe bashkëveprimit.”: Neni 80(2), Ligji për Familjen.

⁸⁶ Neni 82, Ligji për Familjen.

⁸⁷ Neni 83, Ligji për Familjen.

⁸⁸ Neni 1, LPK.

⁸⁹ Neni 386, LPK.

⁹⁰ Neni 390, LPK.

⁹¹ Neni 102, LPK.

⁹² Neni 391, LPK.

⁹³ Neni 394, LPK. Shih po ashtu Nenet 103-115, LPK.

përgjigjet në të.⁹⁴ Përgjigja duhet të përmbajë ose pranimin ose kontestimin e padisë.⁹⁵ Përgjigja duhet të jetë e qartë, e kuptueshme dhe e kompletuar.⁹⁶

- ***Dërgimi i shkresave gjyqësore tek pala***

Shkresat gjyqësore dërgohen me postë, por “mund të dërgohen edhe nëpërmjet punëtorit të autorizuar të gjykatës, të personit juridik të regjistruar dhe autorizuar për kryerjen e punëve të komunikimit.” Shkresat “mund t'i dorëzohen adresatit në gjykatë drejtpërsëdrejti apo në ndonjë mënyrë tjetër të përcaktuar me ligj.⁹⁷ LPK parasheh dispozita për dërgimin e shkresave tek personat juridik,⁹⁸ “personave ose institucioneve në botën e jashtme, apo të huajve që gëzojnë të drejtën e imunitetit” dhe personave juridik që e kanë selinë “në botën e jashtme”⁹⁹ dhe personave të burgosur.¹⁰⁰ Kur pala ka përfaqësues ligjor apo përfaqësues të autorizuar, shkresa mund t'i dërgohet atij përfaqësuesi¹⁰¹ ose, në rast të përfaqësuesit ligjor, mund t'i jepet të punësuarit në zyrën e tij apo të saj.¹⁰² Dërgesa mund të bëhet “çdo ditë nga ora 7,00 - 20,00 në banesën apo në vendin e punës së personit të cilit duhet dorëzuar ato, ose në lokalet e gjykatës kur ky person ndodhet [aty]”, dhe kur dërgesa nuk mund të kryhet kështu “atëherë ai mund të behet në çdo kohe dhe vend tjetër.”¹⁰³

Kur personit të cilit duhet dorëzuar shkresën “nuk gjendet atje ku duhet bërë dorëzimi, dorëzuesi do të njoftohet se kur dhe ku do të mund ta gjejë këtë person dhe do t'ia lejë [...] njoftimin me shkrim që për marrjen e shkresës të jetë në ditën dhe në orën e caktuar në banesën e vet, përkatësisht në vendin e vet të punës.”¹⁰⁴ Nëse personi të cilit duhet dorëzuar shkresën “nuk gjendet në banesën e vet,” shkresa po ashtu mund t'i jepet “ndonjë anëtarit të rritur të familjes së tij, i cili ka për detyrë ta marrë shkresën në dorëzim.” Si alternativë, shkresa “do t'i jepet fqinjtit, po që se pajtohet me një gjë të këtillë.”¹⁰⁵ Kur personi refuzon ta pranojë shkresën “pa ndonjë arsye të ligjshme,” dërgesa mund të kryhet duke e lënë shkresën në banesën ose vendin e punës të adresatit ose duke e bashkangjitur atë “në derën e banesës apo lokalit të punës.”¹⁰⁶ Dërgesa po ashtu mund të kryhet duke e postuar shkresën në tabelën e njoftimeve të gjykatës.¹⁰⁷

⁹⁴ Neni 395(1), LPK. Neni 395(2) kërkon nga gjykata që ta njoftojë të paditurin, në kohën kur ja dërgon padinë, lidhur me obligimin e tij/saj për t'u përgjigjur në padi brenda kohës së specifikuar, dhe për “pasojat procedurale” prej dështimit për ta bërë këtë.

⁹⁵ Neni 396(1), LPK. Kur i padituri konteston padinë, ai apo ajo duhet të deklarojë “faktet mbi të cilat [...] mbështet thëniet e tij dhe provat” në mbështetje të pozitës së tij apo saj: Neni 396(2), LPK.

⁹⁶ Neni 397, LPK. Kur përgjigja nuk është e qartë, e pakuptueshme dhe jo e plotë, gjykata, njëlloj si me ndonjë padi të ngjashme të mangës, do ta ftojë të paditurin që ta korrigjojë apo plotësoj përgjigjen brenda afatit të paraparë, në mungesë të këtij plotësimi apo korrigjimi, gjykata mund ta hedh poshtë padinë.

⁹⁷ Neni 103, LPK. Shih po ashtu Nenin 115, që parasheh alternativa tjera për dërgim përmes zyrës postare.

⁹⁸ Neni 104, LPK.

⁹⁹ Neni 105, LPK.

¹⁰⁰ Neni 106, LPK.

¹⁰¹ Neni 107, LPK.

¹⁰² Neni 108, LPK.

¹⁰³ Neni 109, LPK.

¹⁰⁴ Neni 110, LPK.

¹⁰⁵ Neni 111(1) LPK. Kur shkresa duhet të dërgohet në vendin e punës të personit, dhe personi nuk ndodhet aty, shkresa, “mund t'i dorëzohet personit që punon në të njëjtin vend, në qoftë se ai pajtohet që ta marrë shkresën”: Neni 111(2), LPK.

¹⁰⁶ Neni 112, LPK.

¹⁰⁷ Neni 114, LPK.

- **Seanca përgatitore**

“Sa herë që është e mundur,” gjykata do të konsultohet me palët para se të caktojë seancën përgatitore.¹⁰⁸ Megjithatë, “si rregull,” gjykata do të mbajë seancën përgatitore brenda 30 ditëve pas pranimit të përgjigjes.¹⁰⁹ Seanca përgatitore është e detyrueshme, përveç në raste kur gjykata vjen në përfundim se “ndërmjet palëve nuk ka fakte kontestuese” ose kur për shkak të “pandërlikueshmërisë së kontestit”, gjykata vendos se nuk ka nevojë për seancë të tillë.¹¹⁰ Gjukata do të përdor seancën përgatitore që të sqarojë¹¹¹ çështjet e paraqitura në padi dhe në përgjigje, dhe do të shtjellojë ato çështje¹¹² para seancës së shqyrtimit kryesor. Gjukata do të vendos gjatë seancës përgatitore se a kërkohet dëshmi e mendimit të ekspertit lidhur me ndonjë çështje dhe nëse po, do të caktojë afatin për marrjen e saj.¹¹³ Kur paditësi dështon të paraqitet në seancën përgatitore, edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt, padia do të konsiderohet e tërhequr;¹¹⁴ kur i padituri dështon të paraqitet, edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt, seanca do të vazhdojë në mungesë të tij/saj.¹¹⁵ Kur është e përshtatshme, gjykata do të përdorë seancën përgatitore për të ju ndihmuar palëve që të zgjidhin disa apo të gjitha çështjet mes tyre, përmes “ndërmjetësimit”¹¹⁶ apo “pajtimimit gjyqësor”.¹¹⁷

Para se të përfundojë seanca përgatitore, gjykata do të lëshojë një urdhër me të cilin cakton seancën e shqyrtimit kryesor.¹¹⁸ Urdhri do të nënvizojë çështjet që kanë mbetur të zgjidhen në seancën e shqyrtimit kryesor, dëshmitë që pritet të administrohen lidhur me secilën prej atyre çështjeve dhe personat që do të ftohen për të dëshmuar.¹¹⁹ Gjukata po ashtu duhet të vendos se a do të jetë seanca e shqyrtimit kryesor seancë me “dyer të hapura” apo do të jetë e mbyllur për publikun.¹²⁰ Seanca e shqyrtimit kryesor “si rregull” do të duhet të mbahet brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës përgatitore.¹²¹

- **Seanca e shqyrtimit kryesor**

Pas hapjes së seancës së shqyrtimit kryesor, gjyqtari do të verifikojë praninë e të ftuarve, dhe do të hetojë “shkaqet e mosparaqitjes në seancë.”¹²² Gjukata më pas

¹⁰⁸ Neni 400(3), LPK.

¹⁰⁹ Neni 400(4), LPK. Kur i padituri nuk ka parashtruar përgjigje, gjykata mund ta fillojë seancën përgatitore në çfarëdo kohe pas skadimit të afatit për parashtrim të përgjigjes: Neni 400(2), LPK.

¹¹⁰ Neni 401, LPK.

¹¹¹ Nenet 403-405, LPK.

¹¹² Nenet 406(1) dhe 406(2), LPK.

¹¹³ Neni 407(1), LPK. Palët duhet ta pranojnë mendimin e ekspertit me shkrim “së paku shtatë (7) ditë para seancës së shqyrtimit kryesor”: Neni 407(2), LPK.

¹¹⁴ Neni 409(1), LPK.

¹¹⁵ Neni 409(2), LPK.

¹¹⁶ Neni 411, LPK.

¹¹⁷ Nenet 412-419, LPK.

¹¹⁸ Neni 420(1) (a), LPK.

¹¹⁹ Neni 420(1) (b) deri në (d), LPK.

¹²⁰ Neni 448, LPK.

¹²¹ Neni 420(2), LPK. Megjithatë, gjykata mund të vendos të mbajë seancën e shqyrtimit kryesor “menjëherë pas seancës përgatitore”: Neni 420(3), LPK.

¹²² Neni 423(2), LPK. Kur paditësi dështon të paraqitet në seancën e shqyrtimit kryesor, edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt, gjykata do të konsiderojë se ai apo ajo është tërhequr nga padia. Në raste të veçanta, paditësi mund të kërkohet që procesi të vazhdojë në mungesë të tij/saj: Neni 423(3), LPK.

vendos se a ka pasur ndonjë “pengesë procedurale” për procedimin e mëtejshëm të seancës.¹²³ Seanca e shqyrtimit kryesor do të zhvillohet gojarisht dhe dëshmitë do të administrohen “drejtpërdrejtë pranë gjykatës”.¹²⁴ Seanca e shqyrtimit kryesor do “të zhvillohet në drejtimin e duhur dhe në mënyrë të rregullt, pa shtyrje të panevojshme”.¹²⁵ Atëherë kur është e domosdoshme që seanca të shtyhet, ajo nuk mund “të shtyhet për kohë të pa caktuar”,¹²⁶ e as për më shumë se 30 ditë përveç nëse është e paraparë në mënyrë specifike sipas ligjit.¹²⁷ Nëse seanca shtyhet, gjyqtari “ka për detyrë që t’i merr të gjitha masat e mundshme me qëllim që të hiqen shkaqet që e kanë shkaktuar shtyrjen, si dhe me qëllim që në seancën e ardhshme të përfundoj normalisht shqyrtimi i çështjes.”¹²⁸ Seanca e shqyrtimit kryesor, si rregull do të mbahet “publikisht.”¹²⁹ Përfundimisht, seancat mund të jenë pjesërisht apo plotësisht të mbyllura për publikun.¹³⁰ Kur seanca do të jetë “gjykim me dyer të mbyllura”, gjykata do ta lëshoj vendimin me të cilin e deklaroi këtë, bashkë me arsyetimin, ndërsa vendimi do të jetë publik.¹³¹

- ***Pushteti gjyqësor i hetimeve dhe procedura e provave***

Kur shkurorëzimi bëhet me pajtim të ndërsjellë, gjykata mund të mos hetojë faktet që mbështesin propozimin, përveç nën rrethana të kufizuara ku përfshihen nevojat e “fëmijë[ve] ... përbashkët të mitur” nga martesja.¹³² Megjithatë, faktet “në të cilat pala e mbështet kërkesën e vet në kontestet martesore gjykata mund t’i konsiderojë si të kontestueshme edhe atëherë kur ato fakte janë të pa kontestueshme ndërmjet palëve.”¹³³

Palët duhet të paraqesin provat e nevojshme për ta mbështetur rastin e vet dhe për t’u përgjigjur në rastin e palës së kundërt.¹³⁴ Palët duhet të “paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”¹³⁵ Vendimi nuk mund të bazohet në dëshmi për të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia të përgjigjen.¹³⁶ Gjykata do të vendos lidhur me

Kur i padituri dështon të paraqitë në këtë seancë, edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt, seanca do të vazhdojë në mungesë të ati apo asaj: Neni 423(4), LPK.

¹²³ Neni 424(1), LPK. Gjykata mund ta shtyjë seancën nëse vendos “se nuk janë plotësuar prezumimet ligjore për mbajtjen e saj” ose pritë që provat nuk mund të administrohen në atë seancë: Neni 437, LPK.

¹²⁴ Neni 427, LPK.

¹²⁵ Neni 426(1), LPK.

¹²⁶ Neni 441(1), LPK.

¹²⁷ Neni 441(2), LPK. Gjyqtari duhet ta njoftojë kryetarin e trupit gjykues lidhur me të gjitha shtyrjet dhe ky i fundit duhet të “mbanë evidencë për shtyrjet e seancave për secilin gjyqtar”: Neni 441(3), LPK.

¹²⁸ Neni 441(4), LPK.

¹²⁹ Neni 444(1), LPK. Megjithatë, vetëm të rriturit mund të jenë të pranishëm: Neni 444(2), LPK.

¹³⁰ Seanca mund të jetë e mbyllur për publikun, , inter alia, kur “përmenden rrethana” nga jetët private të palëve, ose jetët e njerëzve të tjerë të përfshirë në proces: Neni 445(c), LPK.

¹³¹ Neni 447(1), LPK. Ligji për Familjen po ashtu parasheh disa seanca që të jenë të mbyllura për publikun; Neni 75 parasheh që publiku do të përjashtohet nga procedurat e “kontestit martesor”, Neni 335 parasheh që publiku të përjashtohet nga “i tërë procesi gjyqësor për mbajtje financiare dhe ushqimi” dhe Neni 345 përjashton publikun nga “kontestet për vërtetim apo kundërshtim të atësisë” dhe “kontestin për kujdestari të personit të mitur”.

¹³² Neni 84, Ligji për Familjen.

¹³³ Neni 85(1), Ligji për Familje.

¹³⁴ Neni 428, LPK.

¹³⁵ Neni 7(1), LPK.

¹³⁶ Neni 7(3), LPK.

pranueshmërinë e secilës dëshmi përmes “çmuarjes me ndërgjegje, e të kujdesshme”.¹³⁷ Secila provë do të ekzaminohet si “veç e veç” ashtu edhe “të gjitha provat së bashku.”¹³⁸ Si rregull, provat do të nxjerrën “në seancën e shqyrtimit kryesor”.¹³⁹

Dëshmitarët duhet të jenë në gjendje të ofrojnë dëshmi që janë relevante për çështjet që shqyrton rasti.¹⁴⁰ Pala që propozon dëshmitarin do të ja ofrojë paraprakisht gjykatës, emrin e dëshmitarit, adresën dhe përmbledhjen e dëshmisë së tij apo saj. Dëshmitarët së pari do të merren në pyetje nga pala që i ka ftuar, e më pas nga pala tjetër.¹⁴¹ Gjykata, në çfarëdo kohe mund ta merr në pyetje dëshmitarin.¹⁴² Dëshmitari çdo herë do të pyetet se si ka arritur t’i ketë të ditura gjërat për të cilat dëshmon.¹⁴³ Palët mund të dëshmojnë në cilësi të dëshmitarëve, subjekt i provimit nga ana e gjykatës.¹⁴⁴ Fëmijët nën moshën 14 vjeçare mund të thirren si dëshmitarë vetëm kur është “e domosdoshme për zgjidhjen e çështjes.”¹⁴⁵ Dëshmitë e ekspertëve mund të nxjerrën, ose në mocion të vet gjykatës ose me kërkesë të palëve.¹⁴⁶ Eksperti do të paraqitet në gjykatë për të dhënë “konstatimin dhe mendimin” e tij apo saj.¹⁴⁷

- ***Caktimi i përfaqësuesve të përkohshëm***

Nën rrethanat ku dështimi për të bërë këtë do të shkaktoje “pasoja të dëmshme për njëri apo për të dy palët”,¹⁴⁸ gjykata do të caktojë një përfaqësues të përkohshëm për të përfaqësuar interesat e të paditurit. Rrethana të tilla përfshijnë rastet kur vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur,¹⁴⁹ dhe rastet kur i padituri ndodhet “jashtë shtetit”.¹⁵⁰ Përfaqësuesi i përkohshëm mund të caktohet po aq herët siç është faza e përgatitjes së rastit, kur kjo gjë do të ndihmonte në zgjidhjen e rastit.¹⁵¹

- ***Roli i Qendrave për Punë Sociale (QSS-ve) në kontestet martesore***

Ligji për Familjen parasheh se QPS do të luajë rol të rëndësishëm si në ndihmën ashtu edhe në këshillimin e gjykatave, gjatë gjykimit të disa llojeve të caktuara të kontesteve martesore.¹⁵² Kur ka fëmijë të mitur nga martesja, QPS-të do të zhvillojnë

¹³⁷ Neni 8(1), LPK. Vendimi do të jetë “në bazë të rezultatit të gjithë procedimit.”

¹³⁸ Neni 8(2), LPK.

¹³⁹ Neni 324(1), LPK. Megjithatë, kur dëshmitë “nuk mund të sjellët në gjykatë”, ose kur të bërit kështu do të “shkaktoje shpenzime të mëdha”, dëshmitë mund të nxjerrën në ndonjë tjetër vend përpos në gjykatë, përmes procedurës së “këqyrja në vend”. “Këqyrja në vend” e tillë mund të bëhet “bashkëveprimin e ekspertit”: Nenet 326 dhe 327, LPK.

¹⁴⁰ Neni 339(1), LPK. Dëshmitarët e ftuar nga gjykata duhet të paraqiten dhe të dëshmojnë.

¹⁴¹ Neni 348(1), LPK.

¹⁴² Neni 348(2), LPK.

¹⁴³ Neni 348(3), LPK.

¹⁴⁴ Neni 373, LPK.

¹⁴⁵ Neni 339(3), LPK.

¹⁴⁶ Nenet 356 dhe 357, LPK.

¹⁴⁷ Neni 359(1), LPK.

¹⁴⁸ Neni 79(1), LPK.

¹⁴⁹ Neni 79(3) (a), LPK.

¹⁵⁰ Neni 79(3) (b), LPK.

¹⁵¹ Neni 387(1) (q), LPK. Ky pushtet ekziston që nga “momenti i arritjes së padisë”.

¹⁵² Neni 14 dhe 7.2, Ligji Nr. 2005/02-L17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, , e shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2005/46, 14 tetor 2005 (po ashtu e publikuar në Gazetën Zyrtare të Kosovës Nr. 2007/12, me 1 maj 2005). Neni 1.3 definon organin e kujdestarisë si “funksion i qendrës për punë sociale përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve.” Teksti në gjuhën shqipe i referohet organit të kujdestarisë si “organi i kujdestarisë,” frazë e cila përkthehet në “autoritet i kujdestarisë” dhe “organi kujdestar” që duket të përdoren njëjtë në kornizën ligjore në Kosovë. Neni 6, i Ligjit

procedura të pajtimit.¹⁵³ Veç kësaj, kur ajo thirret për të vendosur lidhur me çështje të pazgjidhura që përfshijnë “ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve”, gjykata para se të vendos, do të “marr mendimin dhe propozimin”¹⁵⁴ e QPS-së.

Në procedurat civile ku përfshihen fëmijët, gjykata “mund të kërkojë nga [QPS] zhvillimin e hetimeve dhe ofrimin e vlerësimit profesional të rrethanave sociale të personit në fjalë dhe të bëjë rekomandime për mirëqenien e tij të ardhshme.”¹⁵⁵ Pas pranimit të kërkesës së tillë, Drejtori i QPS-së do të “urdhëron fillimin e një hetimi të tillë nga ana e një nëpunësi të shërbimeve sociale të miratuar për këtë destinim dhe i siguron gjykatës raportin e kërkuar.” “Raportet e tilla duhet t’i dorëzohen gjykatës jo më vonë se 21 ditë pas bërjes së kërkesës përveç nëse në kërkesë nuk është përcaktuar ndryshe.”¹⁵⁶ “Gjykata nuk merr vendim përfundimtar në një rast ku nevojitet raporti i tillë derisa nuk i ka vlerësuar sa duhet përmbajtjen dhe rekomandimet e tij.”¹⁵⁷

- **Mbajtja e procesverbalit gjyqësor**

Procesverbali përpilohet “për veprimet e kryera në seancë gjyqësore.”¹⁵⁸ Procesverbali po ashtu përpilohet edhe “mbi deklaratat dhe njoftimet e rëndësishme që i bëjnë palët ose pjesëmarrësit e tjerë jashtë seancës.”¹⁵⁹ Procesverbali do të përpilohet nga procesmbajtësi¹⁶⁰ dhe do të përfshijë “emrin e gjykatës, vendin ku kryhet veprimi, ditën dhe orën kur kryhet veprimi, objektin e kontestit dhe emrat e palëve të pranishme ose të personave të tjerë, si dhe të përfaqësuesve ligjorë ose me prokurë të tyre.”¹⁶¹ Procesverbali gjithashtu duhet të përmbajë “të dhëna esenciale për përmbajtjen e veprimit të kryer.”¹⁶²

për Familjen thotë “(1) Punët e mbrojtjes dhe të ndihmës familjare do t’i ushtron organi kompetent i administratës komunale i cili është kompetent për punët e mbrojtjes sociale. (2) Organi i Kujdestarisë është një organ komunal administrativ kompetent për çështje sociale. Ai përbëhet nga një grup i ekspertëve me përvojë profesionale në fushën e veçantë të përgjegjësisë. (3) Organi i Kujdestarisë mundet gjithashtu të jetë organ (grup i ekspertëve siç është cekur më lart) i veçantë i institucionit social [...]” (4) Organi i Kujdestarisë pjesëmarrës në procedurë është i autorizuar të bëjë propozime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve, të paraqes fakte të cilat nuk janë përfshirë, të propozojë administrimin e provave të domosdoshme, të ushtrorë mjetet juridike dhe të ndërmer veprime tjera gjyqësore. Gjykata është e obliguar të ftojë në gjyq Organin e Kujdestarisë pjesëmarrës në procedurë në të gjitha seancat gjyqësore dhe t’i dorëzojë atij të gjitha vendimet.

¹⁵³ Neni 80(1), Ligji për Familjen.

¹⁵⁴ Neni 140(2), Ligji për Familjen.

¹⁵⁵ Neni 14(1), Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare.

¹⁵⁶ Neni 14(2), Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare. Duhet të nënvizohet se sipas Nenit 293(1), LPK, gjykata, si mjet për të detyruar QPS-në të veprojë në përputhje me kërkesën e saj, mund të shqiptojë gjobë deri në €1.000 për “ekspertin që pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk e dorëzon brenda afatit të caktuar konstatimin dhe mendimin e vet, apo që pa arsye nuk vjen në seancë edhe pse është thirrur [sic] rregullisht.”

¹⁵⁷ Neni 14(3), Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare.

¹⁵⁸ Neni 134(1), LPK.

¹⁵⁹ Neni 134(2), LPK. Megjithatë, “[p]ër deklaratat dhe njoftimet më pak të rëndësishme nuk përpilohet procesverbal, por vetëm do të vihet shënim zyrtar në mbështjellësin e lëndës.”

¹⁶⁰ Neni 134(3), LPK.

¹⁶¹ Neni 135(1), LPK.

¹⁶² Neni 135(2), LPK. Informata të tilla esenciale duhet të përfshijnë “sidomos: nëse seanca është mbajtur me dyer të hapura apo të mbyllura”, deklaratat dhe propozimet e palëve, provat e parashtruara nga ata, deklaratat e dëshmitarëve dhe ekspertëve, dhe “vendimet e gjykatës të marra në seancë, por edhe vendimi burimor i dhënë pas përfundimit të seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes juridike.”

- **Aktgjykimi me shkrim i gjykatës**

LPK përshkruan në detaje atë se çfarë duhet të përfshijë aktgjykimi me shkrim i gjykatës.¹⁶³ Aktgjykimi duhet të përmbajë, *inter alia*, pjesën hyrëse,¹⁶⁴ dispozitivin¹⁶⁵ dhe arsyetimin për dispozitivin. Arsyetimi duhet të përmbajë “kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.”¹⁶⁶ Gjykata duhet të specifikojë se cilat dispozita ligjore janë përdorur gjatë vendosjes së secilës çështje të rastit.¹⁶⁷ Aktgjykimet të cilat dështojnë të jenë në përputhje me këto kushte shkelin LPK-në dhe si të tilla mund të goditen në mënyrë të përshtatshme.¹⁶⁸

MENAXHIMI I RASTEVE NË PROCEDURAT GJYQËSORE FAMILJARE

OSBE është e brengosur se mangësitë serioze në praktikën e menaxhimit të rasteve gjyqësore familjare janë duke çuar në shkelje si të kornizës ligjore në Kosovë ashtu edhe të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Praktikrat jo-adekuate të menaxhimit të rasteve manifestohen me një numër problemesh sistemike, më të rëndësishmet në mes tyre janë vonesat kronike në zgjidhjen e rasteve. Gjithashtu brengosëse janë mangësitë lidhur me shqyrtimin e provave dhe dëgjimin e dëshmitarëve, menaxhimi jo-adekuat i rolit të QPS-ve në procedurat gjyqësore familjare, dështimi për të mbajtur procesverbale të sakta dhe të plota, dhe dështimi për të ofruar aktgjykime të arsyetuara mjaftueshëm.

A) Vonesat

Vonesat në zgjidhjen e rasteve janë endemike në gjykatat në Kosovë; ato janë rezultat më i shpeshtë i vërejtur në praktikrat e dobëta në menaxhimin e rasteve gjyqësore familjare. Këto vonesa rezultojnë nga një numër faktorësh, përfshirë këtu dështimin për të ekzaminuar padinë siç duhet pas pranimit, dështimi për të ja dorëzuar padinë të paditurit brenda kohës së paraparë, dështimi për të mos zhvilluar fare procedurën përgatitore apo ashtu siç parashihet me ligj, dhe dështimi për të caktuar datën për seancën e shqyrtimit kryesor. Faktorët shtesë përfshijnë dështimin e gjykatave për të kërkuar me kohë raportet nga QPS-së, ose për të siguruar zbatimin e atyre raporteve pasi që ato të kryhen, për të shikuar se ato raporte po kryhen brenda kohës së paraparë me ligj, dështimin e palëve për t'u paraqitur në seanca madje edhe kur janë të ftuar në mënyrë të rregullt, për rastet kur një apo më shumë palë në procedurë janë të

¹⁶³ Neni 160(1), LPK.

¹⁶⁴ Neni 160(2), LPK. Pjesa hyrëse duhet të përmbajë “emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit, emrin dhe mbiemrin, vendbanimin [sic], të përfaqësuesve të tyre ligjor [sic], [t]regimin e shkurtër të objektit të kontestit dhe vlerën e tij, ditën e përfundimit të shqyrtimit kryesor, tregimin e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor dhe me prokurë që kanë qenë të pranishëm në seancën për shqyrtimin e tillë si dhe ditën kur është dhënë aktgjykimi.”

¹⁶⁵ Neni 160(3), LPK. Dispozitivi “përmban: vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore, vendimin për ekzistimin apo mosekzistimin e kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesëpadinë si dhe vendimin mbi shpenzimet procedurale.”

¹⁶⁶ Neni 160(4), LPK.

¹⁶⁷ Neni 160(5) LPK.

¹⁶⁸ Neni 181(1), LCP, e lexuar bashkë me Nenin 182(2) (n), LPK.

përfaqësuar, dështimi i përfaqësuesve ligjor për t'i kryer në mënyrë efektive detyrimet profesionale. Madje edhe rasti më i drejtpërdrejtë i shkurorëzimit mund të jetë objekt i shtyrjeve të përsëritura siç ishte në rastin e dhënë më poshtë.

Me 1 dhjetor 2008 paditësja parashtroi padinë pranë gjykatës së qarkut me të cilën kërkoi shpërbërjen e martesës së saj. Paditësja dhe i padituri nuk kishin fëmijë. Seanca e shqyrtimit kryesor për herë të parë u mbledh me 22 qershor 2009. Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses, avokat, u paraqit për të në seancë. I padituri nuk u paraqit; gjyqtari vendosi se nuk ishin përmbushur kushtet ligjore të parapara për mbajtjen e seancës, pasi që nuk kishte dëshmi se a është ftuar në ai mënyrë të rregullt. Me 17 shtator 2009, kur u rihap seanca, avokati i paditëses përsëri u paraqit; megjithatë seanca nuk mund të vazhdonte sepse gjyqtari ndodhej në një seminar. Seancat e caktuara për 28 tetor 2009 dhe 15 dhjetor 2009 ishin shtyrë për shkak të dështimit të vazhdueshëm të të paditurit për t'u paraqitur dhe mungesës së provave që do të tregonin se ai është ftuar në mënyrë të rregullt. Në seancën e 15 dhjetorit 2009, gjyqtari vërejti se fletëthirja në fakt ishte nënshkruar nga dikush tjetër – me sa duket nga vëllai i të paditurit. Gjyqtari urdhëroi policinë që të konstatojë se a banonte me të vërtetë i padituri në komunën e dhënë në padi. Avokati i paditëses kërkoi nga gjykata që të caktojë një përfaqësues të përkohshëm për të përfaqësuar interesat e të paditurit. Gjyqtari refuzoi këtë duke theksuar se policia ende nuk ka pasur mundësinë që t'i përgjigjet urdhrin të gjykatës. Seancat e caktuara për 25 janar 2010 dhe 11 mars 2010 po ashtu ishin shtyrë për shkak të dështimit të vazhdueshëm të të paditurit për t'u paraqitur dhe mungesës së vazhdueshme për ftesë të rregullt. Në seancën e 25 janarit 2010, dukej se policia ende nuk kishte vepruar në pajtim me urdhrin e gjykatës për të zbuluar vendbanimin e të paditurit dhe gjykata përcjelli një urdhër të dytë lidhur me këtë. Në seancën e 11 marsit 2010, gjykata theksoi se policia tashmë kishte mësuar se i padituri jeton në Gjermani, në adresë të panjohur. Me kërkesë të paditëses, gjykata lëshoi një vendim me të cilin caktonte përfaqësues të përkohshëm për të paditurin. Gjykata po ashtu urdhëroi që QPS-ja të njoftohet lidhur me vendimin e gjykatës, dhe që vendimi të publikohet në gazetë ditore dhe në tabelën e gjykatës të njoftimeve. Me 11 maj 2010, seanca u rihap në prani si të avokatit të paditëses ashtu edhe të përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit. Megjithatë, gjykata gjeti se avokati i paditëses nuk kishte publikuar vendimin mbi caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm në gazetë ditore dhe shtyu seancën në mënyrë që kjo të bëhej. Kur seanca u rihap me 24 qershor 2010, të dytë, edhe avokati i paditëses edhe përfaqësuesi i të paditurit u paraqiten në gjykatë dhe seanca më në fund filloi. Avokati i paditëses propozoi dëgjimin e dy dëshmitarëve. Dëshmitari i parë dëshmoi pa ndonjë problem; megjithatë, dëshmitari i dytë nuk kishte letërnjoftimin e kërkuar për identifikim dhe seanca përsëri u shty. Kur seanca u rihap me 26 korrik 2010 dëshmitari i dytë nuk u paraqit. Një dëshmitar i tretë u propozua në vend të tij dhe dha deklaratë. Pas fjalimeve përfundimtare, gjykata lëshoi aktgjykimin me të cilin u martesa u zgjodh.

Shembulli i rastit të mësipërm ilustron mangësitë në praktikat e menaxhimit të rasteve të vërejtura nga OSBE në një numër rastesh në gjykatat e qarkut. Përfundimisht, shqyrtimi i kësaj padie ishte shtyrë për tetë herë në përgjithësi gjatë një periudhe prej tre muajve. Shumica e shtyrjeve ishte shkaktuar nga dështimet me ftesa. Përfaqësuesi

i përkohshëm ka mundur – dhe është dashur të caktohej shumë më herët gjatë procedurës. Dështimi për ta caktuar atë rezultoi në një vonesë shtesë prej gjysmë viti, për një zgjidhje të një rasti të drejtpërdrejtë të shkurorezimit. Shtyrja e parafundit – që doli nga dështimi i pandehur i avokatit të paditëses për të publikuar vendimin për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm në gazetë ditore – ishte jashtë mase shqetësues në atë se nuk ishte përgjegjësi e avokatit të paditëses për ta publikuar vendimin. Ka qenë obligim i gjykatës që ta publikojë këtë vendim, dhe dështimi i saj për ta bërë këtë vonoi procedurën edhe për një muaj e gjysmë tjetër. Shtyrja e fundit rezultoi nga paraqitja e dëshmitarit pa letërnjoftim. Ky problem ka mundur të shmanget përmes shfrytëzimit të duhur të procedurës përgatitore për të identifikuar, ftuar dhe për t'i përgatitur dëshmitarët të japin dëshmi.

Përkundër urdhëresës së ofruar nga praktika gjyqësore e GjEDNJ-së në lidhje me nevojën për përsheptim të veçantë në zgjidhjen e rasteve ku përfshihet kujdestaria e fëmijës, madje edhe këto raste nuk janë imune ndaj vonesave sistemike siç ilustron shembulli i rastit në vijim:

Me 22 prill 2009, paditësi ngriti padinë me të cilën kërkonte kujdestarinë për dy fëmijët e mitur nga bashkësia e tij faktike¹⁶⁹ me të paditurën. Fëmijët kishin mbetur nën përkujdesje të paditësit pas ndarjes së palëve, dhe nuk kishin kontakt me të paditurën. E paditura që nga ajo kohë ishte martuar me një person tjetër. Seanca përgatitore e caktuar për 22 korrik 2009 ishte shtyrë për shkak të mos-paraqitjes së asnjërës palë. Nuk ka pasur dëshmi për të treguar se ndonjëra nga to ishte ftuar në mënyrë të rregullt. Seanca u rihap me 31 korrik 2009; paditësi u paraqit mirëpo e paditura jo. Përpjekjet për ta ftuar të paditurën nuk kishin pasur sukses sepse fletëthirrjet ishin dërguar në adresë të vjetër. Gjykata urdhëroi që të paditurës t'i dorëzohet ftesa në adresë të saj të re. Seanca u rihap me 28 gusht 2009; paditësi u paraqit dhe e paditura nuk u paraqit. Përpjekjet për ta ftuar atë në adresë të re ishin njëjtë të pasuksesshme. Gjykata urdhëroi QPS-në që ta ofrojë adresën e saktë të së paditurës. Në seancat e 8 shtatorit 2009 dhe 18 shtatorit 2009, paditësi u paraqit ndërsa e paditura jo. Për shkak se në gjykatë nuk ishte kthyer dëftesa për praninë të fletëthirrjes, nuk ka qenë e mundur të konstatohet se a ishte ftuar ajo në mënyrë të rregullt. Në seancën e 18 shtatorit 2009, gjykata vendosi ta shtyjë dëgjimin derisa i padituri të ja ofrojë gjykatës adresën e re të së paditurës dhe urdhëroi paditësin që këtë ta bëjë brenda tre ditëve. I padituri kishte sjellë adresën e re dhe gjykata prapë mblodhi seancën e shqyrtimit kryesor me 13 tetor 2009. Megjithatë, që nga ajo kohë, paditësi ishte shpërngulur dhe nuk i kishte dhënë gjykatës adresën e tij të re; si rezultat, ai nuk kishte pranuar fletëthirrjen dhe nuk ishte paraqitur. E paditura përsëri dështoi të paraqitet; megjithatë në këtë rast kishte dëshmi se ajo më në fund ishte ftuar në mënyrë të rregullt. Seanca u rihap me 29 tetor 2009 pa praninë e asnjërës palë. Gjykata ende nuk kishte adresën e re të paditësit; andaj, edhe një herë, ai nuk kishte pranuar fletëthirrjen dhe nuk ishte në dijeni lidhur me seancën dëgjimore. Seanca nuk mundi të mbahej në mungesë të paditësit dhe, prapë u shty. Seanca

¹⁶⁹ Një “bashkësi faktike,” siç është definuar me Ligjin për Familjen është “marrëdhënia faktike midis burrit dhe gruas që jetojnë në çifte, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie. Bashkësia faktike (bashkësia jashtëmartesore) është e barabartë me statusin martesor nga aspekti i të drejtave dhe detyrimeve për përkujdesje, mbështetje financiare reciproke, dhe të drejtat pasurore.” Neni 39(1) dhe (2), Ligji për Familjen.

u rihap me 10 nëntor 2009. Padiësi u paraqit; e paditura prapë dështoi të paraqitet edhe pse e ftuar në mënyrë të rregullt. Për shkak se e paditura nuk e ka arsyetuar mungesën gjykata vendosi të vazhdojë procedurën pa praninë e saj.

Në rastin e mësipërm, praktikat e dobëta të menaxhimit të rasteve rezultuan në vonesa të mëdha e të panevojshme para se rasti përfundimisht të dëgjohej bazuar në merita. Po ta kishte ekzaminuar gjykata rastin siç duhet pas pranimit të tij, me vështrim drejt trajtimit pro-aktiv të çështjes së ftesave, dhe po të ishte përdorur siç duhet procedura përgatitore, shumica e këtyre vonesave do të ishin mundur të shmangen. LPK i jep gjykatave një morri mundësish për trajtimin preciz të llojit të tillë të problemeve rreth ftesave që janë shfaqur në këtë rast dhe prapë gjykata shfrytëzoi vetëm ato më të kufizuarat prej tyre, dhe atë me vonesë.¹⁷⁰ Gjykata nuk kërkoi ndihmën e QPS-së për të gjetur vendbanimin e të paditurës deri pas dështimit të saj për t'u paraqitur, në tri raste të njëpasnjëshme. Nuk ishin shfrytëzuar mjetet alternative për të ftuar të paditurën, ose përmes publikimit të njoftimit në gazetë ditore, ose përmes publikimit të sak në tabelën e njoftimeve të gjykatës.

Me 4 janar 2008, padiësi parashtrori një padi me të cilën kërkonte shkurorëzim nga e paditura dhe kujdestarinë për fëmijën e vetëm të çiftit, vajzën, në atë kohë 16 vjeçe. Në vitin 2003, derisa ende jetonte me të paditurën, i padituri filloi një bashkësi faktike me një femër tjetër, me të cilën kishte tre fëmijë. Si rezultat palët dëshironin të shkurorëzohen. Kujdestaria e vajzës së tyre ishte e vetmja çështje. Për shkak të mangësive në përpilimin e padisë, ajo u kthye mbrapsht nga gjykata me 5 mars 2008. Padiësi parashtrori versionin e korrigjuar të padisë në po të njëjtën datë. Me 12 mars 2008, gjykata kërkoi nga QPS që të përgatis raportin mbi çështjen lidhur me kujdestarinë e fëmijës. QPS nuk i u përgjigj kësaj kërkesë dhe gjykata bëri kërkesën e dytë me 16 janar 2009. QPS-ja ja përcolli gjykatës raportin e vet me 9 shkurt 2009. Me 7 prill 1 2009, gjykata mbajti seancën e pajtimit; palët thanë para gjykatës se nuk dëshirojnë të pajtohen dhe se martesë ka marr fund. Gjykata shpalli seancën e pajtimit të pasuksesshme dhe caktoi seancën për shqyrtim kryesor për të njëjtën datë. Gjykata shqyrtoi raportin e QPS-së, ku thuhej se kujdestaria për vajzën (e cila atëherë kishte 17 vjet dhe do t'i mbushte 18 pas pesë ditësh) do të duhej ti jepet të paditurës. Gjykata miratoi shkurorëzimin siç ishte kërkuar dhe i dha të paditurës kujdestarinë për fëmijën.

Në rastin e shembullit të mësipërm, pjesa më e madhe e vonesës i atribuohet QPS-së e cila dështoi t'i përgjigjet kërkesës së parë të gjykatës për raport. Megjithatë, kjo po ashtu është çështje e menaxhimit të lëndës. Gjykata, pasi që i ka dërguar kërkesën QPS-së, ka qenë e obliguar të monitorojë se a po vepron QPS në pajtim me kërkesën.¹⁷¹ Duke marr parasysh moshën e fëmijës, ka pasur urgjencë të veçantë që kjo çështje të zgjidhet përtej shpejtësisë të zakonshme që kërkohet në rastet e kujdestarisë së fëmijës. Me të vërtetë, po të ishte mbajtur seanca madje edhe pesë ditë

¹⁷⁰ Dërgimi i shkresave gjyqësore është diskutuar në faqe 14 të këtij raporti.

¹⁷¹ Duhet të ri-përsëritet këtu, se bazuar në Nenin 293(1), LPK, gjykata ka pushtetin që, si mjet për ta detyruar QPS-në të veprojnë në përputhje me kërkesat e saj, ta gjobisë deri në 1,000 € "ekspertin që pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk e dorëzon brenda afatit të caktuar konstatimin dhe mendimin e vet, apo që pa arsye nuk vjen në seancë edhe pse është thirrur rregullisht."

më vonë, fëmija do t'i mbushte 18 vjet dhe procedura e kujdestarisë do të ishte e diskutueshme.

Kohëve të fundit OSBE ka raportuar lidhur me përdorimin e procedurave përgatitore në procedurat civile kontestimore më Kosovë.¹⁷² Në atë raport, ishte theksuar se edhe pse të obliguar sipas ligjit, gjykatat që shqyrtojnë procedurat civile kontestimore shpesh dështojnë të ja dërgojnë palës së paditur një kopje të padisë për përgjigje para mbajtjes së seancës së parë, dhe dështojnë të zhvillojnë procedurat përgatitore në përputhje me qëllimin e tyre - përgatitjen e rastit për shqyrtim kryesor. Ndonjë herë, OSBE ka vërejtur se gjykatat fillojnë me seanca përgatitore edhe kur parakushtet e nevojshme për mbajtjen e këtyre seancave nuk janë të pranishme. Përderisa problemet e tilla nuk janë unike për rastet ku përfshihen kontestet martesore, ato shpesh përkeqësohen nga sfidat e veçanta që paraqiten gjatë shqyrtimit të kontesteve martesore.

B) Dëshmitarët dhe provat

OSBE është e brengosur për mangësitë që ka monitoruar si gjatë dëgjimit të dëshmitarëve ashtu edhe gjatë nxjerrjes së provave në procedurat gjyqësore familjare në Kosovë. Sa i përket dëgjimit të dëshmitarëve, në disa raste palëve nuk u është dhënë mundësia të dëgjohej si dëshmitarë për rastet e veta, ose në mbështetje të pohimeve të veta ose në përgjigje të pohimeve të palëve kundërshtarë. Në raste tjera, deklaratat e dëshmitarëve nuk ishin fare objekt i ekzaminimit të ndërsjellë mes palëve, ndërsa në disa raste tjera kjo u bë në mënyrë jo-adekuate. Sa i përket nxjerrjes së provave, në disa raste gjykata refuzoi t'i lejon palët të propozojnë prova relevante. Në raste tjera, gjykata lejoi nxjerrjen e provave qartë jo-relevante- e disa herë – prova paragjyquese nga pala gjyqësore. OSBE ka monitoruar një shembull kur gjyqtari ndërmoi hapa për të siguruar dëshmi me iniciativë të vet, jashtë procedurës gjyqësore.

Paditësja parashtrroi një padi me të cilën kërkonte kujdestarinë për dy fëmijët e mitur, të lindur nga bashkësia e saj faktike me të pandehurin. Paditësja pohonte se i padituri e kishte keqtrajtuar atë gjatë lidhjes mes tyre dhe me kërcënim e kishte detyruar që ta abortojë fëmijën e tretë. Ajo pohoi se pas abortit kishte ikur nga bashkësia dhe kërkoi strehim tek vëllezërit, duke i lënë fëmijët përkohësisht nën përkujdesje të të paditurit. Paditësja kërkoi që fëmijët e mitur të lejohen të dëshmojnë lidhur me keqtrajtimin e saj nga ana e të paditurit. I padituri mohoi pohimet e të paditurës dhe pandehi se ajo vuan nga 'ndonjë sëmundje e mundshme mendore' dhe se ai kishte qëndruar në lidhje me të vetëm për shkak të kërcënimeve nga vëllezërit e saj. Përpos vet të paditurit, asnjë dëshmitar tjetër nuk ishte ftuar për të dëshmuar në rast. Gjatë marrjes në pyetje të ndërsjellë, i padituri ishte pyetur se a kishte raportuar ndonjëherë në polici për kërcënimet e vëllezërve dhe ai u përgjigj në pohim të kësaj. Pasi që përfundoi seanca e shqyrtimit kryesor, gjyqtari "jashtë procesverbalit" por ne prani të monitoruesit të OSBE-së tha se do të ndërmerre hapa për të pranuar raportin e policisë "përmes rrugëve zyrtare të gjykatës." Kjo deklaratë e gjyqtarit nuk ishte futur në procesverbalin e

¹⁷² Raporti i OSBE-së mbi Procedurat Përgatitore në Rastet Civile Kontestimore, (qershor 2010), http://www.osce.org/documents/mik/2010/06/44942_sq.pdf (e qasur me 22 nëntor 2010).

gjykatës. Rrjedhimisht gjykata lëshoi aktgjykimin me të cilin refuzonte kërkesëpadinë e paditëses dhe urdhëroi që kujdestaria e dy fëmijëve të mitur të mbetet me të paditurin. Në aktgjykimin e vet, gjykata nënvizoi se deklarata e të paditurit ishte konfirmuar përmes “shkresave të ofruara nga stacioni policor të cilat dëshmonin se i padituri ishte kërcënuar nga vëllezërit e [paditëses]”.

Në këtë rast, paditësja parashtrroi pohime serioze lidhur me sjelljen e të paditurit, ndërkaq i padituri në anën tjetër parashtrroi pohime serioze lidhur me shëndetin mendor të paditëses. Qartazi, vërtetësia e këtyre pohimeve ishte relevante për çështjen kyçe pranë gjykatës – kujdestarinë e fëmijëve të mitur. Përkundër kësaj, gjykata dështoi ta ftonte paditësen për të dhënë dëshmi, dhe kështu dëgjoi vetëm versionin e të paditurit lidhur me ngjarjet. Fëmijët ishin shumë të vegjël (gjashtë dhe katër vjeçar në kohën e seancës së shqyrtimit kryesor); dhe si të tillë, nuk ka gjasa se gjyqtari do të vendoste t’i dëgjonte ata; megjithatë, duke pasur parasysh se çfarë kishte në dispozicion, gjykata është dashur ta trajtonte qartazi këtë çështje në arsyetimin e vet. Po ashtu duket se gjykata nuk ka marrë në konsideratë që të kërkojë ose raport të QPS-së ose dëshmi tjetër nga mendimi i ekspertit, që ka mundur të ndihmonte në zgjidhjen e çështjes së kujdestarisë për fëmijët. Veç kësaj, gjykata qartazi u mbështet në shkresat e policisë për të konfirmuar deklaratën e të paditurit. Megjithatë, kjo dëshmi ishte marr pasi që seanca kishte përfunduar, andaj palëve nuk u është dhënë mundësia që të përgjigjen në të, në çfarëdo forme.

OSBE po ashtu ka vërejtur mangësi në lidhje me dëgjimin e fëmijëve si dëshmitarë. Në disa raste, fëmijëve nuk u ishte dhënë mundësia që të dëgjoen në çështjet që kanë të bëjnë me ta, në shkelle të qartë si të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ashtu edhe të kornizës ligjore në Kosovë.

Paditësi parashtrroi padi me të cilën kërkonte zgjidhjen e martesës së tij, dhe kujdestarinë e tre fëmijëve nga martesa, vajzat binjake gjashtëmbëdhjetë vjeçare dhe të birin pesëmbëdhjetë vjeçar. Palët ishin ndarë në vitin 2004; fillimisht fëmijët jetonin me paditësin por në vitin 2005 me dëshirë të vet, shkuan të jetojnë me të paditurën. Seanca e pajtimit ishte mbledhur dhe e paditura u paraqit; ajo i tha gjykatës se nuk kishte asnjë mundësi pajtimi. Paditësi dështoi të paraqitet në seancë. Gjykata lëshoi një vendim me të cilin ja referoi rastin QPS-së, për procedura të mëtutjeshme. Këto ishin përfundimisht të pasuksesshme, dhe QPS e ktheu rastin në gjykatë me rekomandim që kujdestaria për tre fëmijët e mitur t’i caktohet të paditurës. QPS në raportin e vet për gjykatën nënvizoi se paditësi nuk kishte bashkëpunuar gjatë tërë kohës, dhe rekomandoi që kontakti i tij me fëmijët e mitur të bëhet “bazuar në marrëveshjen në pajtim me dëshirën e fëmijëve për kontakt.” Një numër shtyrjesh tjera pasuan, të gjitha për shkak të dështimit të së paditurës për t’u paraqitur. Së fundmi, gjykata me kërkesë të avokatit të paditësit vendosi të vazhdojë me seancë të shqyrtimit kryesor në mungesë të së paditurës. Paditësi dhe vëllai i tij, të dytë dëshmuan. Paditësi e informoi gjykatën se, që nga përgatitja e raportit të QPS-së, të dy vajzat e tij ishin martuar. Ai po ashtu e informoi gjykatën se i biri ishte kthyer të jetojë me të por gëzonte kontakt të papenguar me të paditurën. Gjykata nxjerr aktgjykimin në po të njëjtën ditë, me të cilin zgjidhi martesën dhe i caktoi paditësit kujdestarinë për të birin. Rrjedhimisht e paditura kishte parashtruar ankesë kundër aktgjykimit, mbi baza se ajo asnjëherë nuk ishte ftuar në mënyrë të rregullt andaj nuk ka pasur

mundësi të dinte se ishte caktuar seanca e shqyrtimit kryesor. Ankesa akoma nuk është dëgjuar mbi merita të veta.

Ndryshimi i pandehur i rrethanave në situatën e tre fëmijëve të mitur – nga ajo ku tre fëmijët jetonin me bashkëshortin, në tjetrën kur të dy vajzat u martuan dhe i biri jetonte me bashkëshortin – ndërmjet datës nga raporti i QPS-së dhe datës së seancës të shqyrtimit kryesor, diku rreth trembëdhjetë muaj më vonë, është dashur të paraqiste shqetësim për gjykatën. Si të tillë, gjykata është dashur të kërkonte vërtetësi në deklaratën e babait. Si minimum , është dashur një raport i azhurnuar i QPS-së. Megjithatë, e paditura është dashur të thirret në cilësi të dëshmitares për të dhënë versionin e saj të ngjarjeve, veç kësaj edhe fëmijët është dashur të dëgjohen. Fëmijët e mitur, në kohën e seancës së shqyrtimit kryesor ishin 16 dhe 17 vjeçar, dhe si të tillë sigurisht se kanë mundur t’i bëjnë këndvështrimet e tyre të ditura për gjykatën.

Shumica, nëse jo të gjitha, prej këtyre mangësive mund t’i atribuohen dobësive në praktikata e dobëta të menaxhimit të rasteve nga gjykatat në Kosovë. Vlerësimi i duhur i padive nga ana e gjykatave posa ato të pranohen do t’i shpaloste problemet rreth dëshmitave për një veprim pro-aktiv. Dhe shfrytëzimi i duhur i procedurave përgatitore do t’i lejonte gjykatat t’i trajtonte këto probleme në një fazë të hershme.

C) Shqetësimet lidhur me Qendrat për Punë Sociale

Siç u përmend më herët në këtë raport,¹⁷³ Ligji për Familjen parasheh që QPS-të do të përfshihen në ndihmë dhe këshillim të gjykatave gjatë gjykimit të disa rasteve të kontesteve martesore. Përfshirja e QPS-ve kërkohet në procedurat për vërtetimin e atësisë apo amësisë, procedurat e shkurorëzimit ku bashkëshortët kanë fëmijë të mitur dhe për të cilat janë të parapara procedura formale të pajtimit, dhe paditë për kujdestarinë e fëmijëve të mitur. Megjithatë, përkundër këtyre kushteve, OSBE ka vërejtur se gjykatat shpesh dështojnë t’i përfshijnë QPS-të në procedurë të tilla.

Bashkëshorti dhe bashkëshortja parashtruan një padi për zgjidhje të martesës së tyre, me marrëveshje; në propozimin e tyre, ata kërkuan që kujdestaria për tre fëmijët e tyre të mitur t’i takojë bashkëshortes. Qiftit kishte tre fëmijë të moshës 15, 13 dhe 8 vjeçar në kohën kur padia ishte parashtruar. Kur gjykata u mbledh për qëllim të mbajtjes së seancës të pajtimit, palët i thanë gjykatës se ata nuk dëshirojnë të pajtohen dhe i propozuan gjykatës që në vend të kësaj të zhvillojë seancën e shqyrtimit kryesor. Gjykata vendosi që menjëherë ta mbajë seancën e shqyrtimit kryesor; pas shikimit të asgjëje tjetër përpos fletëkurorëzimit dhe certifikatave të lindjes së tre fëmijëve, gjykata në të njëjtën ditë lëshoi aktgjykimin me të cilin zgjidhi martesën dhe i caktoi bashkëshortes kujdestarinë e fëmijëve në përputhje me propozimin e përbashkët të palëve. Bashkëshortit ju caktua që t’i paguaj alimentacion bashkëshortes për të mbështetur fëmijët.

Mbi këto fakte, gjykata ka qenë e obliguar që të zhvillojë procedurë formale pajtimi. Duke marrë parasysh që ka pasur fëmijë të mitur të përfshirë, gjykata është dashur t’i referojë palët në QPS për zhvillim të procedurës. Gjykata po ashtu është dashur të kërkojë raport nga QPS-ja lidhur me çështjen e kujdestarisë së fëmijëve dhe nuk është

¹⁷³ Shih më sipër në fq. 17.

dashur të merr vendim përfundimtar në rast, pa e pranuar raportin dhe pa vlerësuar siç duhet përmbajtjen dhe rekomandimet e tij.

Në rastin e dhënë më poshtë, dështimi për të kërkuar raport të QPS-së ishte edhe më shqetësues, duke marr parasysh natyrën serioze të pohimeve që palët kishin bërë lidhur me njëri tjetrin, dhe ndikimin e mundshëm të këtyre pohimeve, po që se të vërteta, lidhur me aftësinë e tyre për t'i kryer në mënyrë adekuate detyrat e tyre si prind kujdestar i fëmijëve të mitur.

Paditësja kërkoi kujdestarinë për fëmijët e saj të mitur. Paditësja dhe i padituri kishin jetuar në bashkësi faktike dhe kishin dy fëmijë së bashku. Paditësja pohoi se i padituri e kishte abuzuar atë vazhdimisht gjatë lidhjes së tyre, dhe si rezultat, ajo u largua nga ai duke i lënë përkohësisht fëmijët nën përkujdesje të tij. Ajo pohonte se, për shkak se i padituri “herë pas herë” punonte në Slloveni dhe ishte martuar kohëve të fundit, ai nuk ishte në pozicion të kujdeset për fëmijët. Ajo tërhoqi vërejtje se prindërit e të paditurit ishin të papunë dhe se babai i tij ishte i sëmurë, andaj fëmijët nuk do të ishin në gjendje të ndihmojnë rreth kujdesit për fëmijët. I padituri mohoi ta ketë abuzuar paditësen dhe tha se paditësja vuan nga një sëmundje mendore që e kishte bërë atë të paaftë të kujdeset për fëmijët. I padituri argumentoi se përderisa babai i tij me të vërtetë ishte i sëmurë, nënën e tij, motra më e re dhe gruaja e re veçse ishin duke u kujdesur për fëmijët dhe do të mund të vazhdonin ta bëjnë këtë. I padituri po ashtu argumentoi se ai gjeneronte mjaft të ardhura nga puna e tij për të mbështetur fëmijët. Në seancën e shqyrtimit kryesor, paditësja prezantoi me përfaqësuesin e saj të autorizuar dhe i padituri u paraqit personalisht. Pa kërkuar kurrë raport të QPS-së në lidhje me çështjen e kujdestarisë së fëmijëve, gjykata lëshoi aktgjykimin me të cilin refuzoi kërkesën e paditëses dhe urdhëroi që kujdestaria e dy fëmijëve të mitur të mbetet me të paditurin.

OSBE po ashtu ka monitoruar raste në të cilat QPS dështoi të përgjigjet me kohë, apo nuk u përgjigj aspak në referime nga gjykata për procedura pajtimi dhe për raporte në rastet e kujdestarisë së fëmijëve.¹⁷⁴

Paditësi kërkoi kujdestarinë për fëmijën e tij të mitur. Paditësi dhe e paditura ishin shkurorëzuar një vit më herët. Në kohën e shkurorëzimit, kujdestaria për fëmijën i ishte caktuar të paditurës. Paditësi pohoi se, që prej shkurorëzimit, e paditura nuk e kishte respektuar marrëveshjen e palëve lidhur me vizitë të fëmijës. Ai pohonte se e paditura e kishte keqtrajtuar fëmijën, e kishte nxitur atë që ta urrente paditësin dhe familjen e tij dhe e kishte izoluar fëmijën nga ata. Ai tha se kujdestaria për fëmijën duhet t'i bartet atij. Në të kundërtën, paditësi kërkoi që alimentacioni që ai është i obliguar të paguajë të reduktohet. E paditura mohoi pohimet e paditësit. E paditura po ashtu e njoftoi gjykatën se procedura përmbartimore ishte aktualisht pranë gjykatës, lidhur me alimentacionin e papaguar nga ana e paditësit. Ajo tha se nëse paditësi nuk mund të përballojë të paguajë alimentacionin, ai nuk do të ishte në gjendje të

¹⁷⁴ OSBE më herët ka raportuar mbi rolin dhe kryerjen e detyrave të QPS-ve në procedura gjyqësore, shih Raportet Mujore të OSBE-së: *Qendrat për Punë Sociale në Procedurat Civile* (mars 2010), http://intranet/n/s/documents/monitoring/6/10032317_1491_sq.pdf (e qasur me 22 nëntor 2010) dhe: *Procedurat Gjyqësore që Përfshijnë Dhunën në Familje* (nëntor 2009), http://intranet/n/s/documents/monitoring/6/09112557_1346_sq.pdf (e qasur me 22 nëntor 2010).

sigurojë kujdesin për fëmijën si prind kujdestar. Gjykata vendosi ta shtyjë seancën preliminare të dëgjimit në mënyrë që të “kërkoj, edhe një herë, raportin nga Qendra për Punë Sociale”. Seanca preliminare u mbledh muajin e ardhshëm. Shkresa nga QPS-ja, e pranuar nga gjykata në po të njëjtën ditë, e njoftonte gjykatën se QPS nuk ishte në pozitë që të ofrojë raportin e kërkuar “për shkak të sëmundjes së zyrtarit përgjegjës të rastit.” Gjykata vendosi që përsëri ta shtyjë seancën dhe që “përsëri ta urdhërojë Qendrën për Punë Sociale [...] ta dorëzojë raportin.” Seanca e radhës e caktuar, diku gjashtë javë më vonë prapë ishte shtyrë, për shkak se ende nuk ishte pranuar raporti nga QPS, dhe gjykata vendosi që “përsëri ta urdhërojë Qendrën për Punë Sociale [...] ta dorëzojë raportin.” Seanca u mbledh pas dy javësh; raporti i QPS-së, më në fund i pranuar nga gjykata ishte lexuar me zë. Raporti nuk përmbante ndonjë këshillë apo udhëzim mbi çështjen e kujdestarisë së fëmijës. Përfaqësuesi ligjor për të paditurën e kundërshtoi raportin duke argumentuar se ai “dështoi të përgjigjet në pyetjen më esenciale lidhur me vendimin për kujdestari të fëmijës.” Gjykata u pajtua me këtë dhe refuzoi që raporti i QPS-së të merret si dëshmi. Në po të njëjtën ditë, gjykata lëshoi aktgjykim me të cilin refuzonte padinë e ngritur nga paditësi dhe urdhëroi që kujdestaria për fëmijën e mitur të mbetet me të paditurën.

QPS-ja në këtë rast dështoi të përgjigjet në kërkesën e gjykatës brenda afatit kohor të paraparë me Ligjin për Familjen. Raporti i saj, kur përfundimisht u parashtrua, dështoi që në mënyrë adekuate të përgjigjet në çështjen që ishte në qendër të procedurës, do të thotë, për kujdestari të fëmijës së mitur. Ka qenë përgjegjësi e QPS-së që të jep ekspertizë përkatëse dhe me kohë lidhur me kërkesën e gjykatës. Megjithatë, edhe kjo po ashtu është çështje e menaxhimit të rastit, në po aq shumë që është përgjegjësi e gjykatës që të kontrollojë QPS-në siç është e domosdoshme për të siguruar veprim me kohë dhe adekuat, në përputhje me kërkesat e veta. Në këtë rast, kur ka kuptuar se punëtori i QPS-së të cilit i u ishte caktuar rasti, për shkak të sëmundjes nuk ka qenë në gjendje të përfundojë raportin brenda kohës së caktuar, gjykata është dashur të kërkojë që rasti t’i bartet një punëtori tjetër nga QPS-ja për të përfunduar raportin. Dhe kur ky raport përfundimisht ishte pranuar nga gjykata dhe ishte i mangët, gjykata është dashur të ja kthejë atë QPS-së për korrigjime të nevojshme.

D) Procesverbalet gjyqësore të pasakta dhe jo të kompletuara

Si ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut ashtu edhe korniza ligjore në Kosovë parashohin që gjykatat të funksionojnë hapur dhe në mënyrë transparente.¹⁷⁵ Një procesverbal i kompletuar dhe i saktë i të gjitha proceduarave gjyqësore është bazament i një sistemi gjyqësor transparent. Në këtë drejtim, LPK parasheh se procesverbali duhet të përpilohet “për veprimet e kryera në seancë gjyqësore.”¹⁷⁶ Përkundër këtij kushti, OSBE ka vërejtur se, në shumë procedura procesverbalet gjyqësore ishin si të pasakta ashtu edhe jo të kompletuara.

¹⁷⁵ Karakteri publik i procedurave “mbron palët gjyqësore kundër administrimit sekret të drejtësisë pa shqyrtim publik; është po ashtu një ndër mjetet përmes të cilave mund të mbahet besimi në gjykata.” *Mallous kundër Republikës Çeke*, GjEDNJ, aktgjykimi i 12 korrikut 2001, paragrafi 55.

¹⁷⁶ Neni 134(1), LPK.

Në shembullin e rastit të mëposhtëm, procesverbali dështon të tregojë se gjyqtari në fakt mungonte gjatë tërë seancës dëgjimore.

Palët ngritën padi për shkurorëzim me marrëveshje të ndërsjellë. Palët ishin martuar në Gjermani pesë vite më herët dhe nuk kishin fëmijë. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, të dyja palët prezantuan përmes përfaqësuesve të autorizuar përkatës. Procedura ishte zhvilluar nga bashkëpunëtori profesional në vend të gjykatësit, që është shkelje e ligjit. Në përfundim të seancës, bashkëpunëtori profesional lëshoi aktgjykimin me të cilin zgjodhi martesën. Procesverbali gjyqësor, megjithatë përmban emrin e gjyqtarit në vend të atij të bashkëpunëtorit profesional. Kushdo që nuk ishte i pranishëm në sallë të gjykimit do të ishte gabimisht i udhëzuar të besojë se procedura ishte zhvilluar nga gjyqtari.

Është veçanërisht e rëndësishme që procesverbali gjyqësor të tregojë se a ishte apo jo seanca e hapur për publikun. Siç është nënvizuar më herët në këtë raport, LPK parasheh që procesverbali gjyqësor të përmbajë “të dhëna esenciale për përmbajtjen e veprimit të kryer”, përfshirë “sidomos: nëse seanca është mbajtur me dyer të hapura apo të mbyllura”.¹⁷⁷ Por, në një numër mjaft të madh të rasteve të monitoruara nga OSBE, informacioni i tillë ose është regjistruar në mënyrë të pasaktë ose mungon krejtësisht. Për shembull:

Paditësi kërkoi rishqyrtim të një vendimi të mëhershëm me të cilin kujdestaria për fëmijën e mitur i takoi të paditurës. E paditura e kontestoi padinë. Seanca preliminare ishte mbledhur por më pas ishte shtyrë, për shkak se raporti i kërkuar nga QPS nuk ishte pranuar. Edhe pse procesverbalet gjyqësore nuk tregonin se ndonjë raport(e) ishin kërkuar nga QPS, në procesverbal të seancës preliminare thuhej se gjykata po “kërkon, përsëri raport nga Qendra për Punë Sociale.” Seanca preliminare u mblodh përsëri, dhe prapë ishte shtyrë, në dy raste të ndara për shkak se raporti ende nuk ishte pranuar. Kur edhe njëherë ishte mbledhur seanca preliminare, u njoftua se raporti i QPS-së ishte pranuar. Pas dëgjimit të thënieve të palëve lidhur me raport, gjykata përfundimisht vendosi të refuzojë që të lejojë raportin të shqyrtohet si dëshmi dhe lëshoi aktgjykim me të cilin refuzonte padinë. Edhe pse dëgjimi ishte bartur nga seanca preliminare në atë të shqyrtimit kryesor në atë datë, procesverbali i gjykatës dështoi ta pasqyronte këtë fakt. Veç kësaj, edhe pse kërkohet që procedurat që përfshijë kujdestarinë e fëmijëve të mbahen prapa dyerve të mbyllura, procesverbali i gjykatës dështon të tregojë se a ka qenë në fakt kjo procedurë e veçantë, e mbyllur për publikun.

E) Arsyetimi i pamjaftueshëm i vendimeve

Siç është cekur më herët në këtë raport, vendimi i arsyetuar është kusht i paraparë si me ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut ashtu edhe me kornizën ligjore të Kosovës.¹⁷⁸ Arsyetimi adekuat i informon qartë palët lidhur me mënyrën e nxjerrjes

¹⁷⁷ Neni 135(2), LPK. Procesverbalet gjyqësore janë diskutuar në faqen 18 të këtij raporti.

¹⁷⁸ Shih më sipër në fq. 6-7, për konsultim të kushteve nga GjEDNJ, dhe fq. 18-19, për konsultim të kushteve të dhëna në LPK.

dhe arsyet e vendimit të gjykatës. Siç ka nënvizuar GjEDNJ-ja, vendimi i arsyetuar po ashtu “i ofron palës mundësinë e ankesës kundër tij, si dhe mundësinë që vendimi të mund të shqyrtohet nga organi ankimor. Vetëm përmes vendimit të arsyetuar mund të ketë besim të publikut në administrim të drejtësisë [...]”¹⁷⁹

Përkundër kushteve të parapara me ligj për vendim të arsyetuar, OSBE ka monitoruar shumë raste në të cilat vendimet nuk janë të arsyetuara mjaftueshëm. Në disa raste, gjykatat dështuan t’i vlerësojnë dëshmitë në mënyrë adekuate apo nuk i vlerësuan aspak për të gjetur fakte mbi të cilat mund të bazohet vendimi ose për të treguar dispozitat e aplikueshme legislative. Për shembull:

Paditësi ngriti padi për zgjidhe të martesës së tij me të paditurën. Palët kishin jetuar së bashku vetëm për gjashtë muaj pas martesës, kur lidhja u prish dhe ata u ndanë. Ata disa herë tentuan të pajtohen, pa sukses. Nuk ka pasur fëmijë nga martesa. Të dyja palët jetonin jashtë vendit për qëllime pune në kohën kur u ngrit padia. E paditura mbështeti padinë e paditësit dhe kërkoi që martesa të zgjidhet. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, të dytë, paditësi dhe e paditura prezantuan përmes përfaqësuesve të autorizuar. Pasi që të dyja palët ndodheshin jashtë vendit, gjykata përjashtoi procedurën e pajtimit. Duke marr parasysh mungesën e kundërshtimit nga ana e të paditurës në padi, gjykata po ashtu vendosi ta trajtojë padinë si propozim të përbashkët për zgjidhje të martesës me marrëveshje dhe, me aktgjykimin e shpallur gojarisht në përfundim të seancës, martesa u zgjodh. Në këtë seancë nuk u dhanë arsye.

Dy vendimet – për të përjashtuar seancën e pajtimit dhe të trajtojë padinë si propozim të përbashkët – të dyja ishin marr në përputhje me kornizën ligjore në Kosovë siç parashihet për gjykimet e padive të shkurorëzimit. Megjithatë, dështimi i gjykatës për të dhënë aktgjykim të arsyetuar apo për të cituar dispozitat përkatëse, të dyja përbëjnë shkelje të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore¹⁸⁰ dhe KEDNJ-së.¹⁸¹

Dështimi për të dhënë arsye për aktgjykim apo për të cituar dispozitat përkatëse të ligjit është mangësi edhe më serioze kur ndodh në kontekst të rastit lidhur me kujdestari të fëmijës, siç ilustron shembulli i rastit të mëposhtëm.

Paditësi ngriti padi për zgjidhjen e martesës së tij me të paditurën, dhe kërkoi që kujdestaria për fëmijën e tyre të mitur, 16 vjeçar në kohën kur ishte ngritur padia, t’i takoj atij. E paditura u pajtua se martesa kishte marr fund dhe dha pëlqim për zgjidhje të saj. Megjithatë, e paditura kontestoi kërkesën e paditësit për kujdestari të fëmijës. QPS-ja dha mendim me të cilin rekomandoi që kujdestaria t’i takojë të paditurës. Rrjedhimisht, gjykata nxori aktgjykimin me të cilin i caktoi të paditurës kujdestarinë. Megjithatë, me aktgjykim urdhërohej që paditësi t’i ofrojë kontakt të papenguar të paditurës me fëmijën. Ky udhëzim bëri të dukej se kujdestaria e fëmijës i ishte caktuar paditësit, në vend se të paditurës.

Gabimi në këtë aktgjykim lë paqartësi lidhur me atë se a i ishte caktuar në fund paditësit apo të paditurës kujdestaria për fëmijën e mitur. Po të ishte arsyetuar siç

¹⁷⁹ *Tatishvili kundër Rusisë*, GjEDNJ, aktgjykimi i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58.

¹⁸⁰ Nenet 160(5) dhe 175, LPK.

¹⁸¹ Neni 6(1), KEDNJ dhe jurisprudenca e vendosur në bazë të saj. Shih futnotat e mësipërme 16-18.

duhet aktgjykimi, do të ishte e qartë se a kishte gjykata për qëllim që të ja caktojë kujdestarinë të paditurës. Megjithatë, në mungesë të arsyeve, nuk është e mundur që kjo të konstatohet me ndonjë siguri.

Shembulli i rastit në vijim ka të bëjë me çështjen e vizitës së fëmijëve dhe përsëri ilustron problemet që mund të rrjedhin kur aktgjykimi nuk është i arsyetuar në mënyrë adekuate.

Palët ngritën padi për shkurorëzim me marrëveshje të ndërsjellë. Ata kishin qenë të martuar për 24 vite dhe kishin pesë fëmijë, vetëm njëri nga të cilët ende ishte i mitur. Paditësi përkohësisht jetonte në Zvicër ndërsa e paditura jetonte në Kosovë. Palët bashkërisht propozuan që martesë e tyre të zgjidhet, që kujdestaria për fëmijën e tyre të mitur, i biri 12 vjeçar, t'i caktohet paditësit dhe që e paditura të ketë kontakt të papenguar me fëmijën. E paditura u tërhoq nga e drejta e saj për alimentacion dhe palët u tërhoqën nga e drejta e tyre për të parashtruar ankesë ndaj vendimit të gjykatës. Mendimi i QPS-së i kërkuar nga gjykata, mbështeti propozimin e palëve dhe nënvizoi që fëmija kishte shprehur dëshirën që me paditësin të shkojë në Zvicër. Gjykata lëshoi aktgjykimin menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, me të cilin zgjodhi martesën, bashkëshortit i caktoi kujdestarinë për fëmijën dhe e urdhëroi bashkëshortin që të paguajë alimentacion për bashkëshorten në shumë prej €100 në muaj. Në aktgjykim nuk u përmend fare çështja e vizitës së fëmijës të mitur nga bashkëshortja.

Në këtë rast, dështimi i gjykatës që të arsyetojë në mënyrë adekuate vendimin e vet në lidhje me çështjen e vizitës është shqetësues. A kishte gjykata për qëllim që të ja lejojë nënës ta vizitojë fëmijën e saj, siç parashtruan palët qartë në propozimin e tyre të përbashkët? Dëshmitë e nxjerra në seancë sugjerojnë që i ati i fëmijës – tanimë prindi kujdestar – mund në fakt ta merr fëmijën në Zvicër. Nëse është kështu, si do të ndikojë kjo në të drejtën e nënës për ta vizituar fëmijën? Një aktgjykim i arsyetuar do t'i ndihmonte palët – dhe lexuesit tjerë të aktgjykimit – të kuptojnë vendimin e gjykatës lidhur me këto çështje.

PËRFUNDIM

Procedurat e monitoruara nga OSBE zbulojnë probleme të konsiderueshme sistemike në gjykimin e rasteve gjyqësore familjare, në gjykatat në Kosovë. Monitorimi i OSBE-së i procedurave gjyqësore familjare ka identifikuar pesë çështje veçanërisht shqetësuese; këto janë: vonesat e mëdha në zgjidhjen e rasteve madje më të drejtpërdrejta të kontesteve martesore, mangësi serioze gjatë dëgjimit të dëshmitarëve dhe nxjerrjes së provave, mbikëqyrje jo-adekuate gjyqësore të rolit të QPS-ve në rastet gjyqësore familjare, procesmbajtje jo e saktë dhe jo e kompletuar dhe aktgjykimet pamjaftueshëm të arsyetuara.

Gjykimi efektiv i procedurave gjyqësore familjare kërkon një qasje pro-aktive gjithëpërfshirëse për menaxhim të lëndëve. Qasja e tillë duhet të përfshijë tërë kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore familjare, duke filluar nga dita kur është ngritur padia dhe duke vazhduar deri në përfundim final të rastit. Qasja e tillë, e implemetuar në mënyrë efektive do të reduktonte apo eliminonte llojet e vonesave të vërejtura nga OSBE dhe do të kontribuonte në zgjidhjen e problemeve tjera procedurale që janë objekt shqyrtimi në këtë raport. Gjykimi i rasteve gjyqësore familjare përfaqëson sfidat e veta unike në cilindo juridiksion ligjor. Megjithatë, kjo vlen edhe më shumë për rastin në Kosovë, ku njëra e ndonjëherë edhe më shumë palë të rastit shpesh jetojnë jashtë vendit. Këto sfida, megjithatë, nuk janë të pakapërcyeshme. Ato mund, dhe në të vërtetë duhet të plotësohen nëse gjykatat veprojnë në përputhje me ligjin vendor dhe standardet relevante ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Një strategji efektive për menaxhim të lëndëve në rastet gjyqësore familjare është kryesore për sundim të ligjit. Kur gjykata në Kosovë dështojnë që në mënyrë efektive t'i menaxhojnë këto procedura, efikasiteti i sistemit gjyqësor si tërësi, zbehet me këtë rast. Është e qartë se puna e gjykatave në Kosovë është e penguar nga kufizime të dukshme logjistike dhe do të mbetet kështu e penguar për një kohë të shkurtë. Megjithatë, një strategji gjithëpërfshirëse pro-aktive për menaxhim të procedurave gjyqësore familjare mund të ndihmojë që të eliminohen shpenzimet e resurseve gjyqësore që duket se pa ndonjë ndryshim rezultojnë gjithmonë kur këto raste menaxhohen dobët. Strategjia gjithëpërfshirëse pro-aktive për menaxhim të rasteve po ashtu do të mund të shërbente si mbrojtje efektive e të drejtave të palëve në rastet gjyqësore familjare, siç garantohen me Nenet 6 dhe 8 të KEDNJ-së, dhe të drejtave të fëmijëve të përfshirë në rastet gjyqësore familjare, siç garantohen me Nenet 3, 9 dhe 12 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës.

Ligji për Familjen i Kosovës, siç është cekur edhe më herët në këtë raport e definoi familjen si “bashkësi vitale” dhe si “bërthamë natyrore dhe themelore e shoqërisë”. Parasheh se zgjidhja e martesës dhe të gjitha procedurat përcjellëse gjyqësore të zhvillohen “me një minimum të shqetësimit për palët dhe fëmijët e prekur”, dhe se këto procedura duhet të kryhen në atë mënyrë që të promovojnë “sa më mirë marrëdhënie të vazhdueshme mes palëve dhe fëmijëve të prekur” dhe pa “shpenzime të paarsyeshme të përfshira në lidhje me procedurat”. Procedurat gjyqësore familjare kanë potencial që të ndikojnë dhe të definojnë përmbajtjen thelbësore të jetës private dhe familjare të një individi. Inicimi i procedurave gjyqësore familjare nga palët nxit obligim përkatës pozitiv për institucionet që të mbrojnë të drejtat e anëtarëve të familjes në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ka shumë në

barrë të atyre individëve kur familja vjen para gjykatës që të kërkojë zgjidhjen e martesës dhe/apo kujdestarinë, apo vizitën e fëmijës. Gjykatat në Kosovë duhet të plotësojnë sfidën për t'i gjykuar ato çështje në mënyrën më të mirë të mundur për të gjithë ata që janë të përfshirë.

REKOMANDIME

Për gjykatat:

- Të zhvillojë dhe të implementojë një strategji gjithëpërfshirëse pro-aktive për menaxhim të rasteve për ta përdorur atë në procedurat gjyqësore familjare;
- Të shfrytëzoj në tërësi procedurat përgatitore për të radhitur çështjet e rastit;
- Të trajtojë në mënyrë pro-aktive problemet që mund të pritët të dalin nga fletëthirjet për seanca, veçanërisht kur njëri apo dy palët jetojnë jashtë vendit;
- Të trajtojë në mënyrë pro-aktive problemet që mund të pritët të dalin rreth çështjeve lidhur me dëshmi, duke pasur parasysh kushtet e parapara me LPK dhe udhëzuesit e ofruar nga praktika gjyqësore e GjEDNJ-së;
- Kur përfshirja e QPS-së parashihet për procedurat e pajtimit ose për përgatitjen e raportit lidhur me kujdestarinë apo vizitë të fëmijës, të bëjë të gjitha referimet dhe/apo kërkesat sa më herët që është e mundur gjatë procedurës;
- Të diskutojë me palët në fazë të hershme të procedurës, se përpos raportit të QPS-së a është e nevojshme edhe dëshmia e ekspertit për të zgjidhur çështjet rreth kujdestarisë apo vizitave të fëmijëve;
- Të sigurojnë që për secilën procedurë gjyqësore familjare të përpilohen procesverbale të kompletuara dhe të sakta, dhe çfarëdo gabime apo mangësi në procesverbale të korrigjohen sa më parë që të jetë e mundur;
- Kur është e përshtatshme, të marrin parasysh që të shfrytëzojnë dispozitat përkatëse nga Ligji mbi Procedurën Kontestimore për të shqiptuar gjoha monetare apo masa tjera ligjore ndaj dëshmitarëve ekspertë apo përfaqësuesve të autorizuar;
- Të sigurojnë që gjyqtarët që udhëheqin procedurat familjare, në veçanti procedurat që përfshijnë çështjet lidhur me kujdestarinë apo vizitat e fëmijëve, të lëshojnë aktgjykime të arsyetuara siç duhet.

Për Institutin Gjyqësor të Kosovës (IGJK):

- Të vazhdojë të trajtojë si gjyqtarët aktual ashtu edhe kandidatët për gjyqtarë mbi ato që vijojnë:
 - rolin e gjykatave në zgjidhjen e kontesteve gjyqësore familjare;
 - aplikimin e Ligjit për Familjen dhe Ligjit mbi Procedurën Kontestimore;
 - rëndësinë e implementimit të strategjive gjithëpërfshirëse efektive për menaxhim të rasteve;
 - rëndësinë e shfrytëzimit të tërësishëm të procedurave përgatitore në lëndët civile, përfshirë edhe rastet gjyqësore familjare;
 - përdorimin e duhur të procedurës së provave në procedurat gjyqësore familjare; dhe
 - rëndësinë e lëshimit të aktgjykimeve të arsyetuara siç duhet në procedurat gjyqësore familjare.

Për Qendrat për Punë Sociale (QPS-të):

- Të sigurojnë që zyrtarët e QPS-ve të përgjigjen në kërkesat e gjykatave për ndihmë, brenda afatit kohor të paraparë nga legjislacioni përkatës;
- Kur kërkohen mendimet e ekspertit, të sigurojnë që zyrtarët e QPS-ve të japin mendime që përgjigjen në çështjet e ngritura.